



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“FINANCË”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë

Kolegji Universitar “Reald”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.As.Dr Etleva LESKAJ
2. Dr. Enis FITA

Mars/2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në “Financë” ofruar nga Institucioni i Arsimit të
Lartë Kolegji Universitar “REALD”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “REALD”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Financës (Fakulteti i Ekonomisë)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Financë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 650, datë 14.09.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MAS Nr. 409, datë 11.09.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	UMAS Nr. 403, datë 26.07.2016 (Akreditim me kusht); UMAS Nr. 600, datë 22.12.2016 (Hiqen kushtet) Vendim nr. 159, datë 16.05.2016; Vendim nr. 208, datë 18.11.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike/6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 Kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	NA
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	NA
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	NA
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2019 - 2020: 11 PAE / 0 PAK 2020 - 2021: 13 PAE / 1 PAK 2021 - 2022: 14 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	2019 – 2020; 3 studentë 2020 – 2021; 7 studentë 2021 – 2022; 10 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Financë" ka filluar të zhvillohet në vitin 2011 dhe në vazhdim. Ai është hapur me VKM nr. 650, datë 14.09.2011 të KM, "Për dhënien e lejes për hapjen e Akademisë së Studimeve të Aplikuara "REALD". Programi zhvillohet nga Departamenti i Financës, të Fakultetit të Ekonomisë, pranë Kolegjit Universitar "Reald". Objektivi kryesor i programit Bachelor në Financë është përgatitja e specialistëve të lartë që t'i përgjigjen kërkesave të kohës, nevojave të tregut rajonal, kombëtar dhe atij ndërkombëtar të punës, për përballimin e kërkesave të një ekonomie gjithmonë në progres.

Tërësia e njohurive, që marrin studentët, ndikon në formimin e përgjithshëm teorik në fushën e shkencave të ekonomisë, financës, financës dhe kontabilitetit, me objektiv dhënien e njohurive bazuar në arritjet më të fundit bashkëkohore në fushën e shkencave ekonomike e të financave dhe përvojat shumëvjeçare të studimit të këtyre aspekteve në realitetin shqiptar. Programi synon të përgatisë studentët me konceptet bazë mbi rolet dhe funksionet e një financieri në një drejtim financiar të njësie ekonomike, etj. Gjithashtu, ky program synon të përgatisë specialistë për vazhdimin e studimeve të mëtejshme në fushën e financës. Në përfundim të programit studenti aftësohet për t'u punësuar në njësitë e ndryshme ekonomike dhe sektorët që lidhen me funksionet bazë të financierit. Njohuritë që ofrohen nga ky program dhe kompetencat, që marrin studentët nëpërmjet harmonizimit të njohurive me bazë teorike, të fushës dhe ato ndihmëse e duke vijuar me thellime në fushën e financës etj., krijojnë bazën për një karriere kërkimore dhe akademike duke mundur vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë. Mundësitë për punësim realizohen nga nevojat e tregut për financierë të kualifikuar.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë ta paraqesin sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (ascal.al, standardet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof.As.Dr. Etleva Leskaj dhe Dr. Enis Fita. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Z. Erion Xhako, Znj Alma Arapi përfaqësues të ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në Kolegjin Universitar REALD që u zhvillua në datën 12-13 Qershor 2023 sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit, intervistave, komenteve për DVV, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Bachelor në “Financë”. Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analizë mbi programin e studimit që akreditohet, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të studentëve të diplomuar. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra me programin e studimit Bachelor në “Financë” duke dhënë disa sugjerime/rekomandime.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin nr. 159, datë 16.05.2016, janë:

Programi i studimit e ka bërë akreditimin e parë në vitin 2016. Fillimisht është akredituar me kusht, me Urdhër nr. 403, datë 26.07.2016, “Për akreditimin me kusht të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Financë” të Akademisë së Studimeve të Aplikuara “Reald” Vlorë”, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, bazuar në Vendimin nr. 159, datë 16.05.2016, të Këshillit të Akreditimit të arsimit të lartë, i cili ka vendosur:

1. Të rekomandojë që programi i studimit Bachelor në “Financë”, të akreditohet vetëm për brezin e studentëve që kanë përfunduar studimet brenda vitit akademik 2015 – 2016.
2. Institucioni përpara fillimit të vitit akademik 2016 – 2017, për studentët që janë në vazhdim të programit të studimit Bachelor në “Financë”, të plotësojë kushtet si më poshtë:
 - a) Të rishikohet personeli akademik duke shtuar atë me grada/tituj dhe përvojë akademike.
 - b) Të realizohet një shpërndarje më e mirë e orëve mësimore pasi stafi akademik efektiv, jep më shumë se dy lëndë.
 - c) Të përmirësohet biblioteka me literaturë ndihmëse në gjuhë të huaj dhe literaturë bazë pasi rezulton me shumë pak tituj dhe të krijohet mundësia për tu abonuar në bibliotekëelektronike. Të kualifikohet stafi ndihmës i angazhuar në sekretarinë mësimore dhe zyrën e burimeve njerëzore për zbatimin e përpiktë të rregullave që lidhen me dokumentacionin, regjistrat etj.
 - d) Të realizohet një studim tregu rreth mundësisë së punësimit të këtyre të diplomuarve veçanërisht në tregun lokal/rajonal ku operon Institucioni.

- e) Të realizohen marrëveshje me biznese lokale (duke i dokumentuar) për krijimin e mundësisë së praktikave profesionale dhe/apo të punësimit të studentëve pas diplomimit.
 - f) Të sigurohet informacion nga Institucioni mbi punësimin me kohë të plotë të stafit PAK, dhe njëkohësisht të sigurohen lejet nga këto institucione, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e programit të studimit. Kjo vlen dhe për stafin akademik që vjen nga jashtë vendit.
 - g) Të rregullohet mënyra e korigjimit të provimeve pasi mos sekretimi i tyre më parë, potencialisht mbart rrezikun e cenimit të paanshmërisë dhe objektivitetit të vlerësimit të studenteve.
 - h) Me paraqitjen e plotësimit të kushteve nga Institucioni ekspertë të fushës me përfaqësues të Këshillit të Akreditimit do të organizojë një tjetër vizitë në Institucion për verifikimin e plotësimit të kushteve si më lart.
3. Këshilli i Akreditimit i rekomandon gjithashtu Ministrin të Arsimit dhe Sportit që Akademia e Studimeve të Aplikuara “Reald”, Vlorë, të mos pranojë e regjistrojë studentë të rinj në këtë program studimi, deri në përmbushjen e kushteve si më lart.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni Vendimin nr. 208, datë 18.11.2016

IAL me shkresën nr. 157, datë 13.10.2016 ka informuar Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për plotësimin e kushteve të vendosura për akreditimin e programit të studimit. Ndërsa, pas plotësimit të kushteve është bërë akreditimi përfundimtar me Urdhër nr. 600, datë 22.12.2016, “Për plotësimin e kushteve për akreditimin e programit të vendosura me Urdhër nr. 403, datë 26.07.2016, “Për akreditimin me kusht të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Financë” të Akademisë së Studimeve të Aplikuara “Reald” Vlorë”, të ministrisë të Arsimit dhe Sportit, bazuar në Vendimin nr. 208, datë 18.11.2016, të Këshillit të Akreditimit të arsimit të lartë, i cili ka vendosur:

1. Akademia e Studimeve të Aplikuara “REALD”, i ka plotësuar kushtet e vëna në Urdhërin e Ministrin të Arsimit dhe Sportit Nr. 403, datë 26.07.2016, për programin e studimit Bachelor në “Financë”.
2. Mbështetur në gjithë sa më sipër, Këshilli i Akreditimit jep vlerësim përfundimtar pozitiv për programin e studimit Bachelor në “Financë”, të Akademisë së Studimeve të Aplikuara “REALD” dhe rekomandon heqjen e kushteve të akreditimit sipas Urdhërit të Ministrin të Arsimit dhe Sportit Nr. 403, datë 26.07.2016.
3. Institucioni do të monitorohet nga APAAL dhe KA për ndjekjen e treguesve të cilësisë për këtë program studimi. IAL, brenda vitit akademik 2016-2017, të raportojë pranë APAAL mbi përmirësimin në vijim të këtyre treguesve dhe veçanërisht për cilësinë e literaturës bazë dhe dytësore në mbështetje të këtij programi studimi.
4. Këshilli i Akreditimit i rekomandon Ministrisë së Arsimit dhe Sportit që programi i studimit Bachelor në “Financë”, të Akademisë së Studimeve të Aplikuara “REALD”, të akreditohet.

Kolegji Universitar “Reald”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 10.03.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 31 / 8 Prot, datë 11.03.2024. Kolegji Universitar “Reald”, njofton në ASCAL më datë 13.03.2024, me anë të shkresës me Nr.102 Prot, datë 13.03.2024 “ Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	GVJ konstaton se kriteri përmbushet plotësisht pasi kjo pasqyrohet në: Strategjinë e zhvillimit Institucional, “IAL-ja angazhohet në ndërtimin e marrëdhënieve me komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar në drejtim të konsulencës nëpërmjet qasjes së akademikëve dhe studiuesve për transferimin e njohurive, inkurajimin e sipërmarrjes dhe pronës intelektuale. (Evidenca 3); në Rregulloren e Përgjithshme të Institucionit mbështetur në LAL 80/2015 (Evidenca 5). <i>Evidenca 3. Strategjia e Zhvillimit të Institucionit.</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e Institucionit.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ konstaton që kriteri përmbushet plotësisht pasi IAL funksionon me strategji zhvillimi, në misionin dhe vizionin e të cilit janë parashikuar se profilet e studimit janë përzgjedhur me qëllim që studenti të reflektojë kërkesat e tregut të punës dhe të plotësojë nevojat intelektuale në të ardhmen. (Evidenca 3, pikat A dhe B). <i>Evidenca 3. Strategjia e Zhvillimit të Institucionit.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	GVJ konstaton se kriteri përmbushet plotësisht pasi organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje të plotë me objektivat dhe strategjinë afatmesme të IAL; programi Bachelor në “Financë” e zhvillon veprimtarinë e vet në bazë të një strategjie zhvillimi institucional (Evidenca 3) . Programi i studimit është hartuar në përputhje dhe në zbatim të Statutit (Evidenca 2) , Rregulloren e Përgjithshme (Evidenca 5) dhe Rregulloren e Fakultetit Ekonomik (Evidenca 6) , në të cilat janë parashikuar drejtimet prioritare akademike. <i>Evidenca 2. Statuti i IAL.</i> <i>Evidenca 3. Strategjia e Zhvillimit të Institucionit.</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e Institucionit.</i> <i>Evidenca 6. Rregullore e Njësisë Kryesore.</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	GVJ konstaton se kriteri përmbushet plotësisht. KUR ka eksperiencë gati 10 vjeçare në fushën akademike, fillimisht në fushën e mjekësisë e më pas edhe në degët e ekonomisë. Staf i akademik i cili është i përfshirë në fushën e mësimdhënies (Evidenca 20) plotëson kriteret ligjore lidhur me gradat dhe titujt akademik. Departamenti që zhvillon këtë program studimi ka staf me grada Profesor, Profesor i asociuar, Doktor, si dhe Master i shkencave (Evidenca 21).

	<p><i>Evidenca 20. Të dhëna tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë bazë;</i> <i>Evidenca 21. Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit (për tre vitet e fundit).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstaton se përmbajtja dhe organizimi i studimeve janë ndërtuar në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Ekonomisë, me legjislacionin dhe me aktet ligjore dhe nënligjore shqiptare dhe ato evropiane (Evidenca 3; Evidenca 5, Evidenca 6). Sipas verifikimit (Evidenca 76) programi është kodifikuar me Vendim të Senatit Akademik duke vijmësuar procedurën për dërgim dhe miratim nga organet kompetente. <i>Evidenca 3. Strategjia e Zhvillimit të Institucionit.</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e Institucionit.</i> <i>Evidenca 6. Rregullore e Njësisë Kryesore.</i> <i>Evidenca nr. 76. Tabela e kodifikimit të programeve të studimit.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se programi i studimit ka vite që ofrohet nga IAL, ka kaluar një proces të mëparshëm vlerësimi dhe është në përputhje të plotë me interesat kombëtare, strategjitë zhvillimore si dhe me profilin dhe dokumentat, strategjitë të IAL.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës GVJ konstaton se për zhvillimin e programit ka një angazhim dhe sinergji të stafit dhe me njësitë e tjera në IAL Gjatë takimit me drejtuesin e njësisë kryesore dhe njësisë bazë dhe stafit përgjegjës për programin e studimit u konstatua se përgjegjësitë dhe rolet sipas qëllimit dhe objektivave të programit njihen dhe zbatohen si dhe janë subjekt analize periodike për arritjen e tyre. Evidenca 20 <i>Evidenca 31. Analizë e Departamentit mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisht profesional.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos</p>	<p>GVJ konstaton se për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, Institucioni ka nënshkruar marrëveshje</p>

<p>marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>bashkëpunimi me Institucione publike dhe private për zhvillimin e praktikave mësimore.</p> <p>(Evidenca 26; Evidenca 27; Tab. 5 - Aneks të dhënat tabelore).</p> <p><i>GVJ dhe nga takimi me drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë, sugjeroi për intesifikimin e marrëveshjeve me palët e interesuara në funksion të përfitueshmërisë së programit.</i></p> <p><i>Evidenca 26. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe praktikën profesionale.</i></p> <p><i>Evidenca 27. Disa nga marrëveshjet e bashkëpunimit Tab. 5 - Aneks të dhënat tabelore.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>GVJ konstaton se për realizimin e programit të studimit, KUR ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe ndërmarrje shtetërore, si: Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë së Qarkut Vlorë, Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Portit Vlorë, si dhe me disa hotele të qytetit të Vlorës (Hotel “Partner”, Hotel “Vlora International”, Hotel “Regina City”, dhe kompani të tjera, për realizimin e praktikave mësimore të studentëve (Evidenca 26; Evidenca 27).</p> <p><i>Evidenca 26. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe praktikën profesionale.</i></p> <p><i>Evidenca 27. Disa nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës me drejtuesit e njësisë bazë, GVJ konstatoi se njësia bazë ndjek vijueshmërinë e përfitueshmërisë nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të objektivave formuese teorike dhe sidomos ato të formimit praktik të studentëve të programit të studimit Bachelor në “Financë”.</p> <p><i>Evidenca 28. Raporti periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se IAL, KUR ka një sërë marrëveshjesh me institucione publike dhe private për realizimin e komponentit praktik të programit të studimit. GVJ sugjeron intesifikimin e marrëveshjeve për të rritur përfitueshmërinë e studentëve në këtë program studimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Financë” është i organizuar në lëndë dhe module sipas veprimtarive formuese (A-E) në përputhje me VKM 41/2018. (Tabela 9)</p> <p>Nga konstatimi i dokumentacionit, referuar Evidencës 13 dhe 14, shpërndarja e veprimtarive paraqitet (A-F) dhe nuk është respektuar gërmëzimi (A-E) sipas VKM 41/2018 i perditësuar. <i>Ky konstatim u trajtua dhe gjatë vizitës në institucion ku nga pergjegjesit u argumentua se është bërë një lapsus dhe që do të ridërgoheshin dhe njëherë përmes ASCAL.</i></p> <p><i>Aneks RVB Bachelor ne Financë. Tabela nr. 9 “Plani mësimor sipas veprimtarive”</i></p> <p><i>Evidenca 13. Plani mësimor i programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca 14. Programi i studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ konstaton se qëllimi i programit të studimit konsiston në pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme për formimin e tyre si specialistë të Financës në të gjitha fushat e saj. Për realizimin e këtij objektivi programi parashikon harmonizimin e njohurive duke filluar me ato bazë teorike, të fushës dhe ndihmëse duke vijuar me thellime në fushën e financës, etj. (Evidenca 7, neni 9).</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc (neni 9).</i></p>




Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

GVJ konstaton se programi i studimit ka të përcaktuara veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

Si më poshtë tabela e detajuar e veprimtarive:

PLANI MËSIMOR për programin e studimit Bachelor ne Finance		
Tipi i Veprimtarisë (A-E)	Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
LËNDË BAZË – A - Përgatitje e përgjithshme dhe kulturore metodologjike 15-20% (29 kredite)	Mikroekonomi	7
	sociologji	6
	Makroekonomi	8
	Matematike e perthitgjshme	8
Shuma e krediteve ECTS		29
LËNDË KARAKTERIZUJËSE – B -përgatitje per disipinen shkencore 50-55% (97 kredite)	Bazat e finances	7
	Mikro e ndermjetme	6
	parimet e marketingut	6
	Statistike	8
	Matematike financiare	7
	Kontabilitet financiar	7
	Finance publike	7
	menaxhim biznesi	8
	Menaxhim i burimeve njerezore	6
	Kontabilitet Kosto-drejtimit	6
	Paraja dhe Banka	7
Investime	7	
Biznesi nderkombetar	7	
Drejtimit Financiar	8	
Shuma e krediteve ECTS		97
LËNDË NDERDISIPLINORE/ INTEGRUJËSE – C -nendisiplina profile dhe grup-lende me zgjedhje 12-15% (29 kredite)	Shkrim Akademik	6
	E drejte biznesi	5
	Baza Kontabiliteti	6
	Gjuhe e huaj 2	6
	Anglisht	
	Italisht	6
Etike biznesi		
Komunikim Biznesi	6	
Shuma e krediteve ECTS		29
LËNDË PLOTËSUESË – D -gjuhe e huaj, njohuri informatike, praktike profesionale 10-15% (18 kredite)	Gjuhe e huaj 1 (Anglisht)	5
	Informatike	7
	Praktikë mesimorë	6
Shuma e krediteve ECTS		18
DETYRIME PËRMBYLLËSE (E)		
E-Detyrime përmbyllëse 3-5 % (7 kredite)	Mikroteza	7
Totali		180

Tabela nr. 9. "Plani mësimor sipas veprimtarive", Aneks RVB. Bachelor ne Financë.

Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.

GVJ konstatoi se programi mësimor në strukturën e tij paraqet realizimin e praktikës mësimore sipas veprimtarisë formuese tipi D me një ngarkesë 6 kredite (ECTS).

Tabela nr. 9. "Plani mësimor sipas veprimtarive", Aneks RVB. Bachelor ne Financë.

Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse,

GVJ referuar dokumentacionit si dhe vizitës në IAL, konstaton se njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin ka të përcaktuara në rregulloret përkatëse formën e organizimit të programit të studimit si dhe pranimin e studentëve në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore në fuqi.

Evidenca 6. Rregullore e Njesisë Kryesore.

Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc.

të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.									
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	GVJ konstaton se në Fakultetin e Ekonomisë ofrohen dy programe studimi Bachelor në Financë dhe Menaxhim, të cilat kanë përmbajtje të ngjashme deri në 70% të kurrikulës.								
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Referuar dokumentacionit GVJ konstaton se programi i studimit është i pajisur me kodin përkatës të kodifikimit <u>63BA0412S</u> (Evidenca 76; Evidenca 13;). Gjithashtu, konstatohet se secila lëndë përmban kodin përkatës të kodifikimit (Tabela 10) Sipas verifikimit të dokumentacionit (Evidenca 76) programi është kodifikuar me V.SA duke vijmësuar procedurën për dërgim dhe miratim nga organet kompetente. Tabela nr. 10. “Plani mësimor sipas veprimtarive”, Aneks RVB. Bachelor ne Financë. <i>Evidence nr. 76. Tabela e kodifikimit të programeve të studimit.</i>								
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N/A								
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi. Gjithashtu, institucioni duhet të ridërgojë Planin Mësimor i programit (Evidenca 13; 14) me veprimtari (A-E) duke iu referuar Tab. 9 të paraqitur në Aneksin e të dhënave si dhe konformitetet me VKM 41/2018 i përditësuar.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>GVJ konstaton se Fakulteti i Ekonomisë ka në përbërjen e tij dy departamente: i Financës dhe Menaxhimit, si dhe një Qendër kërkimore, ku secila njësi ka numrin e mjaftueshëm të personelit me tituj dhe grada duke plotësuar detyrimet ligjore. (Evidenca 20).</p> <p>Referuar dosjes së vetëvlerëimit, (Tabela 2, Evidenca 20) konstatohet se stafi akademik i Departamentit të Financës, përmbush kërkesat ligjore, për nivelin e kualifikimit akademik. Në këtë departament për vitin 2019-2020 janë të përfshirë 7 pedagogë PAE; për vitin 2020-2021 janë të përfshirë 7 pedagogë PAE dhe 2 pedagogë PAK; për vitin 2021-2022 janë të përfshirë 8 pedagogë PAE dhe 4 pedagogë PAK.</p> <table border="1" data-bbox="614 1052 1396 1489"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2019-2020</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021 – 2022</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>3</td> <td>-</td> <td>3</td> <td>-</td> <td>5</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>7</td> <td>-</td> <td>7</td> <td>2</td> <td>8</td> <td>4</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Tabela 2. Aneks tabelat permbledhese</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc.</i> <i>Evidenca 20. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse;</i> <i>Evidenca 21. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit (për tre vitet e fundit);</i></p>	Tituj/grada	2019-2020		2020-2021		2021 – 2022		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	-	-	-	-	-	-	Prof.As.Dr	2	-	2	1	1	1	Dr/PhD	2	-	2	1	2	2	Msc	3	-	3	-	5	1	Në total	7	-	7	2	8	4
Tituj/grada	2019-2020		2020-2021		2021 – 2022																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-																																											
Prof.As.Dr	2	-	2	1	1	1																																											
Dr/PhD	2	-	2	1	2	2																																											
Msc	3	-	3	-	5	1																																											
Në total	7	-	7	2	8	4																																											
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin</p>	<p>GVJ konstaton se referuar planit mësimor, program nuk ka një natyrë specifike teknike, të mbështetur në orë laborator, por pavarësisht natyrës së programit të studimit Bachelor në “Financë”, nga vizita në institucion dhe nga konsultimi i organogramës së institucionit, rezulton se institucioni garanton staf ndihmës akademik për realizimin e orëve</p>																																																




në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	laboratorike të programeve të studimit si në orët e lëndës së informatikës, apo të mbështetjes së studentëve gjatë procesit të shkrimit të temave të diplomës. Referuar Tabeles 12.2, Departamenti i Financës ka parashikuar duke vënë në dispozicion një pedagog tutor për mbulimin e orëve të praktikës mësimore. Kjo u verifikua dhe gjatë vizitës në institucion. <i>Evidenca nr. 66.</i> Organigrama e IAL.pdf <i>Tabela 12.2. Aneks tabelat përmbledhëse</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Gvj konstaton se njësia kryesore/bazë e ka përmbushur këtë kriter duke paracaktuar dhe miratuar kordinatorin për mbulimin e programit Bachelor në Financë. <i>Evidenca 29.</i> Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit <i>Evidenca 49.</i> Detyrat e koordinatorit të programit.			
Konkluzione	GVJ bazuar në vlerësimin e DVV, por dhe nga vizita në insitucion, është e mendimit se Njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Financë" përmbushin plotësisht standardet e cilësisë në organizimin dhe drejtimin e tyre në funksion të programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ bazuar në DVV si dhe gjatë vizitës në KUR, konstaton se njësia kryesore/bazë përgjegjëse përmbush plotësisht këtë kriter sa i takon të gjithë dokumentacionit që nevojitet për organizimin dhe drejtimin e programit Bachelor në "Financë" sipas kërkesave të LAL.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i	GVJ bazuar në dosjen e vetvlerësimit dhe Plani mësimor (Evidenca 14), konstaton se programi përmbush kriteret detyruese të informimit: informacion mbi insitucionin; informacion mbi programin e studimit;

<p>nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>objektivat formuese specifike të programit; etj. Plani Mësimor përmban të gjitha elementët detyrues të përcaktuara: kategorinë, semestrin, kreditet (ECTS), orët në audior dhe orët e pavarura individuale për studentin.</p> <p><i>Evidenca 13. Plani mësimor i programit të studimit;</i> <i>Evidenca 14. Programi i studimit;</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ bazuar në DVV (Rregulloret e njësisë kryesore, Rregulloren e Programit të studimit bachelor ne Financë), si dhe gjatë vizitës në KUR konstaton se ky kriter përmbushet sa i takon informacionit lidhur me kriteret e pranimit (kreu III, Rreg. e Njësisë Keyesore/Kreu III, Rreg. Programit të Studimit) si dhe transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve i cili është parashikuar në rregulloret e institucionit, por sipas vizitës në KUR, ndiqet dhe vijëmësia e udhëzimeve të MAS lidhur me specifikat e transferimit..</p> <p><i>Evidenca 6. Rregullore e Njësisë Kryesore</i> <i>Evidenca 7. Rregullore e programit të studimit Bsc.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ bazuar në DVV konstaton se Dosja e programit përmban informacionet e nevojshme lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ programin mësimor (Evidenca 14); ✓ planin mësimor me të gjithë parametrat (Evidenca 13); ✓ syllabuset e lëndëve (Evidenca 18); ✓ kalendarin e provimeve (Evidenca 58); ✓ strukturën e vitit akademik (Evidenca 21); ✓ CV-të e stafit akademik (Evidenca 19); ✓ të dhëna për regjistrimin e studentëve sipas viteve akademike, (Evidenca 23); ✓ modelin e diplomës të miratuar (Evidenca 15); ✓ modelin e suplementit të diplomës, (Evidenca 16), etj.
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVJ bazuar në vizitën në institucion konstatoi se nevoja për përmirësim dhe përditësim të programit të studimit mbështetet kryesisht në vlerësimin e studentëve të mbledhura nga pyetësoret. GVJ gjatë takimit me drejtuesit, sugjeroi thellimin e studimeve duke përfshirë partnerët homologë, palët e interesuara/grupet e interesit për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave ritmike të zhvillimeve më të fundit në fushën e financës dhe ekonomisë.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se programi i studimit është i detajuar dhe informues në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë. Plani mësimor (Evidenca 13; 14) rezulton i pa standadizuar me veprimtaritë (A-E) duke iu referuar Tab. 9 të paraqitur në Aneksin e të dhënave si dhe në përputhje me VKM 41/2018 i përditësuar.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ, bazuar në DVV konstaton se programi Bachelor në “Financë” paraqet në përmbajtje raportin e nevojshëm teori-praktikë në përmbushje të nivelit të kornizës së kualifikimit të ciklit parë të studimeve. Gjatë vizitës në institucion, bazuar dhe në numrin e vogël të studentëve në këtë program, <i>GVJ sugjeroi që njësia duhet të vijojë një studim tregu të thelluar për të ballafaquar kërkesë - ofertën në funksion dhe të rritjes së numrit të të regjistruarve në afatgjatë për këtë program studimi.</i> <i>Evidenca 24. Të dhëna Tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve/Analize e gjurmimit te studenteve.</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	GVJ konstaton se objektivat formuese të këtij programi janë orientuar drejt formimit në fushën e shkencave ekonomike duke i dhënë aftësi studentit të ndjekë kualifikime të mëtejshme nëpërmjet trajnimeve të edukimit në vazhdim për profesionin e financës apo dhe për ndjekjen e një programi të ciklit të dytë të studimeve. <i>Evidenca 13. Plani mësimor i programit të studimit.</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	GVJ konstaton se profili i programit është në përputhshmëri me strukturën , përmbajtjen dhe organizimin sipas nivelit të kornizës kombëtare dhe europiane të kualifikimit. <i>Evidenca 14. Programi i studimit.</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi mësimor, paraqitet me module me kredite, të ndarë sipas viteve akademike dhe semestrave, që mundësojnë arritjen e objektivave formues të këtij programi studimi. Rregullorja e programit parashikon mundësinë e transferimit të studimeve bazuar në kreditet e fituara. (Evidenca 7).

<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ konstaton se Syllabuset e programit (Evidenca 18) kanë përmbushur kriteret sipas VKM 41/2018 e ndryshuar (Shtojca nr. 2). <i>Nga evidentimi u konstatua se syllabuset kryesisht përmbushin kriteret e VKM, por GVJ sugjeron që njësia duhet të përmirësojë literaturën e detyrueshme dhe atë këshilluese në fuksion të përditësimit të programit me të rejat më të fundit në fuksion të cilësisë së programit të ofruar.</i> Evidenca 18. Syllabuset.</p>			
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>GVJ konstaton se elementet e përfshira në programin e studimit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit me lëndët teorike, puna e pavarur në përgatitjen e projekteve, detyrave të kursit, e shoqëruar me praktikën profesionale dhe kompetencat e nevojshme dhe rezultatet e pritshme. Evidenca 14. Programi i studimit</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja dhe struktura e oraganizmit të programit të studimit Bachelor në “Financë” është në përputhje me nivelin përkatës të kuadrit kombëtar dhe evropian të kualifikimit për të mundësuar vijimin e studimeve në ciklin e dytë të studimeve si dhe me rezultatet e pritshme të të nxëniet të nevojshme për tregun e punës në fushën e financës. Evidenca 14. Programi i studimit (pika II, gërma “c”).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ sugjeron se njësia duhet të vijojë një studim tregu të thelluar për të ballafaquar kërkesë ofertën në fuksion dhe të rritjes së numrit të të regjistruarve në afatgjatë për këtë program studimi si dhe të përmirësojë literaturën e detyrueshme dhe atë këshilluese në fuksion të përditësimit të programit me të rejat më të fundit në fuksion të cilësisë së programit të ofruar.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p align="center">Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe</p>	<p>GVJ konstaton se në hartimin e programit të Financës, Grupi i punës së hartimit të programit është konsultuar me partnerët duke marrë në konsideratë mendimet dhe propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>

<p>ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p><i>Evidenca 26. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale;</i> <i>Evidenca 27. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe për praktikën profesionale; https://unireald.edu.al/partnere/</i> <i>Evidenca 54. Praktika e IAL per hapjen e programit te studimit.</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se institucioni ruan dhe mirëmban marrëdhënie të vazhdueshme me studentët e diplomuar përmes zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe seksionit përkatës ALUMNI. Zyra mban komunikim të vazhdueshëm me studentët e diplomuar duke evidentuar pozicionimin progresiv të tyre në karrierë. <i>Evidenca 12. Rregullore e zyrës së Këshillimit dhe Karrierës;</i> <i>Evidenca 24. Të dhëna Tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve/Analize e gjurmimit te studenteve.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>IAL KUR ka ndërtuar një prateritet bashkëpunimi, kryesisht në funksion të zhvillimit të praktikës mësimore, me IAL private dhe publike (Tabela 5, Aneks të dhënat për programin; Evidenca 26), rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale në funksion të rishikimit, përditësimit dhe riorganizimit të programit. <i>Evidenca 26. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale;</i> https://unireald.edu.al/partnere/</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni nxit marrëdhënien me partnerë, rrjete dhe organizata të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
---	-----------------------	------------------------------	--	------------------------------

III.MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ konstaton se format e mësimdhënies, mësimnxënies e transmetimit të njohurive përfshijnë: leksione dhe seminare, leksione të hapura, detyra/projekte kursi, raste studimore, të pasqyruara në syllabuset lëndore; praktikë profesionale, detyrime përmbyllëse.</p> <p>Evidenca. 14 Evidenca. 18 https://unireald.edu.al/aktivitete-shkencore/</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik zhvillon mësimdhënien në forma, mënyra, metoda të ndryshme për t'ju përgjigjur larmisë dhe nevojave të studentëve, praktikë kjo e evidentuar edhe nga takimet në institucion.</p> <p>GVJ konstaton se institucioni ka dhe rregulloren e etikës për stafin dhe studentët.</p> <p>Evidenca 43 Kodi i Etikes.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se nga DVV si dhe gjatë vizitës në institucion se stafi akademik ka patur nxitjen për pjemësmarrje në trajnime dhe aktivitete shkencore si dhe institucioni ka një fond të veçantë për financimin e stafit për pjesëmarrje në aktivitete didaktiko-shkencore.</p> <p>(https://unireald.edu.al/aktivitete-shkencore/) Evidenca 53. Bordi i administrimit në IAL ka fond të veçantë për kërkimin shkencor të stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënien në këtë program studimi plotëson kriteret ligjore të kualifikimit. Ai angazhohet në nxitjet e studentëve dhe mësimnxënien nëpërmjet detyrave të kursit dhe aktiviteteve për çdo lëndë.</p> <p>Niveli profesional i stafit pasqyrohet edhe në CV-të e tyre, ku evidentohen kualifikimet, trajnimet dhe botimet e tyre ndër vite (Evidenca 19).</p> <p>Referuar syllabyseve është përcaktuar si kriter vlerësimi frekuentimi dhe aktivizimi i studentëve në orët e mësimin. (Evidenca 18).</p> <p>Institucioni mbështet studentët në aktivitetet e tyre (Evidenca 52).</p> <p>Studentët kanë në dispozicion dhe manualin për udhëheqjen e diplomës. (Evidenca 46) <i>Udhëzuesi per punimin e temes se diplomes.pdf</i></p>

ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.				
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Institucioni i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. GVJ mësoi gjatë takimeve në institucion se NJSBC ndërmerr vlerësime nëpërmjet pyetësorit të studentëve dhe stafit akademik, me qëllim që të identifikojnë problemet që duhen përmirësuar dhe vlerësojnë arritjet. Gjithashtu, pyetëm dhe morëm përgjigje gjatë takimeve në IAL, se nuk ka patur raste vërejtjesh për përmirësim apo ndryshime për format e metodat e mësimdhënies</p> <p>Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike në përfundim të çdo semestri studentëve u shpërndahen pyetësorë (Evidenca 47). Të dhënat përpunohen nga NJSBC, nga e cila përgatitet raportet e vlerësimit të brendshëm në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe raportit pedagog-student. (Evidenca 30).</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ konstaton nga DVV por dhe nga vizita në institucion se në KUR funksionon NJSBC (Evidenca 25) e cila në përmbushje të misionit të saj në funksion të cilësisë bashkëpunon me njësitë e tjera jo vetëm përmes anketimit periodik adresuar studentëve (Evidenca 47), stafit akademik dhe ndihmësakademik (Evidenca 33) po dhe për kushtet që ofron IAL për studentët (Evidenca 48), por dhe përfshirjes në aktivitete informuese në kuadër të përmirësimit të cilësisë.</p> <p>GVJ konstaton se KUR mbështet zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies pasi institucioni cdo vit harton planin e punës së aktiviteteve vjetore, ku parashikohen leksione të hapura, konferenca dhe trajnime në funksion të rritjes profesionale por dhe përmirësimit të metodologjisë së veprimtarisë mësimore-kërkimore.</p> <p>Evidenca 35(<i>Te dhena te plota te aktiviteteve per kualifikimin dhe kerkimin shkencor te stafit akademik ne 5 vitet e fundit.pdf</i>) Evidenca 53(<i>Plan pune per kerkimin shkencor.pdf</i>) Evidenca 55 (<i>Raport per kerkimin shkencor 2021-2022.pdf</i>)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ është e mendimit se Institucioni garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, për të siguruar arritjen e rezultateve për programin e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi III.2**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>GVJ konstatoi nga takimet në KUR dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, se institucioni përdor metoda të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e studentëve. Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi, teste me alternativa përgjigjesh si dhe provime përfundimtare. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit të Provimeve. Kontrolli i njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet: angazhimit në diskutime gjatë leksioneve e seminareve, por edhe në formë kolegjumesh dhe detyrash të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës; rastet studimore për problematikën e disiplinës; provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara përgjatë zhvillimit të lëndës. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve.</p> <p>GVJ konstaton se njësitë kryesore/bazë kanë rregulloret e tyre të funksionimit dhe të programit në të cilën janë të përcaktuara kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale.</p> <p>Këto rregullore janë publike dhe gjenden edhe online në faqen elektronike të IAL-së (https://unireald.edu.al/legjislacioni/). Gjithashtu, IAL ka hartuar dhe miratuar edhe një rregullore të posaçme, e cila lidhet me rregullat e zhvillimit të provimeve.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Institucionit</i> <i>Evidenca 6. Rregullore e Njësisë Kryesore</i> <i>Evidenca 44. Rregullore e zhvillimit të provimeve.</i></p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Pedagogu i lëndës, para fillimit të çdo semestri, bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe elementët e tjera të syllabusit. Specifikimet e çdo lënde përkatëse jepen nëpërmjet syllabuseve sipas (evidencës 18) specifikisht për programin e studimit. Syllabuset informojnë studentët për përmbajtjen e lëndës dhe mënyrën e vlerësimit kur regjistrohen dhe në fillim të çdo lënde.</p> <p><i>Evidenca 18. Syllabuset e lëndëve.</i></p>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore	<p>Sipas evidencës 18 (syllabuset) vlerësimi i njohurive në secilën lëndë të programit të studimit bëhet në mënyrë kumulative. Gjithashtu, IAL ka</p>

20

<p>realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>hartuar dhe miratuar edhe një rregullore të posaçme, e cila lidhet me rregullat e zhvillimit të provimeve. <i>Evidenca 18. (Syllabuset e programit Bachelor në Financë..pdf)</i> <i>Evidenca 44. (Rregullore e Zhvillimit te Provimeve.pdf)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në KUR dhe nga DVV se njësia përgjegjëse dhe stafi akademik i programit mblidhen në fund të vitit akademik për të vlerësuar dhe përmirësuar format e metodat e mësimdhënies. Në mbledhjet e departamenti ftohen edhe përfaqësues të studentëve të programit të studimit. Po ashtu, NJSBC bën vlerësime nëpërmjet pyetësorit online që shpërndahet në fund të çdo semestri për të marrë mendimet e studentëve në lidhje me metodat e mësimdhënies. Të dhënat përpunohen nga NJSBC që harton raportin përkatës me rekomandimet përkatëse për kompetencë Rektorit me qëllim marrjen në konsideratë dhe përfshirjen në planin e punës për vitin e ardhshëm akademik.</p> <p><i>Evidenca 30. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i> <i>Evidenca 47. Formular NJSBC, vlerësim i studentit per pedagogun</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit. Gjatë vizitës në KUR u konstatua se përgjegjësi i departamentit dhe stafi akademik i programit investojnë në ndërtimin e marrëdhënieve dhe të respektit të ndërsjellë mes tyre. KUR nxiti stafin akademik për pjesëmarrje në trajnime brenda dhe jashtë IAL në funksion të përmirësimit të metodave të mësimdhënies. Bordi i administrimit ka fond të veçantë për kërkimin shkencor të stafit akademik. Udhëzuesi për hartimin e Temës së Diplomës dhe manuale për përdorimin e platformës online të mësimin janë një mbështetje e vlefshme për studentin.</p> <p><i>Evidenca 18. Syllabuset e lëndëve</i> <i>Evidenca 46. Udhezues i IAL per hartimin e temës së diplomës</i> <i>Evidenca 52. Vendim i Bordit të Administrimit per miratim fondi për Këshillin Studentor</i> <i>Evidenca 53. Plan pune i kërkimit shkencor</i> <i>Evidenca 61. Google Classroom (Manual për studentin)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.

Nga verifikimet gjatë vizitës në institucion, u konstatua që vlerësimi i njohurive, aftësive dhe dijeve të studentit realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe studentët janë njohur për të në rregulloren e Fakultetit dhe rregulloren e Departamentit dhe rregulloren e provimeve. Ky vlerësim ndahet në dy pjesë: Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit dhe vlerësimi përfundimtar. Nota përfundimtare del si rezultat i mbledhjes së pikëve të vlerësimit të vazhduar dhe provimit përfundimtar.

Këto rregullore janë publike dhe gjenden edhe online në faqen elektronike të IAL-së (<https://unireald.edu.al/legjislacioni/>).

Evidenca 18. Syllabuset e lëndëve;

Evidenca 44. Rregullore e zhvillimit të provimeve.

Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.

GVJ konstaton gjatë vizitës në institucion, se sistemi elektronik mundëson akses në informacion lidhur me procesin mësimor, syllabuset, leksionet e parashikuara apo prezantimet në powerpoint në hapësirën e pedagogut, detyrimet lëndore, oraret e mësimit dhe kalendarin e provimeve, vlerësimin e çdo lënde etj.

Gjithashtu për studentët e ardhshëm apo për publikun e gjerë, një pjesë esenciale e këtij informacioni konstatohet se ofrohet edhe nëpërmjet webit zyrtar në tre gjuhë: shqip, italisht dhe anglisht.

home - Collegio Universitario REALD (unireald.edu.al)

Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.

GVJ konstaton se njësia përgjegjëse në fund të semestrit harton grafikun e provimeve për të zhvilluar testimin dhe vlerësimin përfundimtar të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin (evidencë 18). Vlerësimi përfundimtar bëhet në përputhje me syllabusin, ku llogaritet shuma kumulative e elementëve të vlerësimit të vazhduar.

Evidenca 59. Kalendari i zhvillimit të provimeve.

Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.

Gjatë takimeve me studentët, GVJ u informua që ata që në fillim të lëndës orientohen nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe detyrimeve të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me menyrën se si do të realizojnë këtë detyrë kursi apo projekt, i cili në fund të lëndës apo modulit prezantohet nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të modulit (kjo bëhet në forma të ndryshme sipas rastit në ppt, etj. në orët e fundit të seminareve). Një procedurë e tillë mundëson marrjen e feedback-ut si nga pedagogu ashtu dhe nga studentët e tjerë në lidhje me aspektet pozitive të punimit

	<p>apo elementët që kanë nevojë për përmirësim apo detajim të mëtejshëm. Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/ përmirësojnë aftësitë e tyre prezantuese. Në raste paqartësish, studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të pedagogut të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Institucionit. (Neni 58).</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>GVJ konstaton se njësitë përgjegjëse që ofron programin e studimit dhe stafi akademik i angazhuar në program marrin masa ndaj studentëve për të shmangur plagjiaturën në detyrat e tyre të kursit. Gjithashtu, komisioni përgjegjës për provimet e secilës lëndë, ndalon në mënyrë të rreptë kopjimin në provimet e ndërmjetme apo në ato përfundimtare.</p> <p><i>Evidenca 43. Kodi i Etikes</i> <i>Evidenca 44. Rregullore e zhvillimit të provimeve.</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> <p>Shkalla e përvetësimit të dijeve vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash 1 deri te 10. Nota më e ulët kaluese është nota 5 (pesë). Në procesverbalet e vlerësimit përfundimtar për studentin jo kalues (ngelës) vendoset nota 4 (katër). Në të gjitha format e kontrollit të dijes përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht kthehet në notë sipas tabelës përkatëse.</p> <p><i>Evidenca 44. Rregullore e zhvillimit të provimeve.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>GVJ duke vlerësuar DVV dhe gjatë vizitës në institucion konstaton se studentvë u garantohej trasnparenca e vlerësimit si dhe kërkesa e rishikimit të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Studenti ka të drejtën e ankimimit për rezultatin përfundimtar të provimit. Sipas Rregullores së institucionit (Neni 59) si dhe dhe takimit me studentet, ata i drejtohen Departamentit për fillimin e procedurave për ngritjen e një komisioni Ad-hoc për ri-vlerësimin e provimeve të studentëve që kanë ngritur këtë pakënaqësi.</p> <p><i>Evidenca 5 (Neni 58,59,60). Rregullore e Institucionit.</i> <i>Evidenca 44. Rregullore e zhvillimit të provimeve.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ është e mendimit se institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. GVJ sugjeron që institucioni të pajiset me një</i></p>

	<i>sistem të dedikuar për verifikimin e plagjaturës për temat e diplomave të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Objektivi kryesor i programit Bachelor në “Financë” është t’u japë studentëve njohuritë e nevojshme për formimin e tyre si specialistë të financës në të gjitha fushat e saj. Në funksion të këtij, objektivi kryesor programi Bachelor në “Financë”, synon dhënien e një tërësie njohurish në formimin e përgjithshëm teorik në fushën e shkencave të ekonomisë, financës dhe kontabilitetit, në veçanti si dhe financës, marketingut me objektivi kryesor formimin e specialistëve bazë të aftë për të punuar në sektorin e financës dhe për realizimin e studimeve të avancuara në këtë fushë. Për realizimin e këtij objektivi programi parashikon harmonizimin e njohurive duke filluar me ato bazë teorike, të fushës dhe ndihmëse duke vijuar me thellime në fushat e marketing, financës, etj. <i>Evidenca 14. Programi i studimit.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Në programin e studimit përfshihen lëndë të formimit të përgjithshëm, me zgjedhje, formuese dhe integruese, karakterizuese, të cilat garantojnë zhvillimin e aftësive të vecanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, gjuhës së huaj etj. Pjesë e kurrikulës së programit mësimor janë modulet: “Hyrje në informatikë”; Gjuhë e huaj (Anglisht 1&2); Sociologji; E drejtë Biznesi dhe Komunikimi në Biznes (Evidenca 13). Programi i studimit zhvillohet në gjuhën shqipe. <i>Evidenca 13. Plani mesimor i programit të studimit.</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	GVJ konstatoi se në syllabuset e çdo lënde studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulën përkatës. Njësisia kryesore dhe departamenti, vlerësojnë kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti në mënyrë periodike dhe në fund të programit të studimit. Përmbledhjet që bëhen në fund të çdo lënde për njohuritë e marra, detyrat e kursit, si përgatitje për provimin dhe si përmbledhje praktike tregojnë plotësimin e këtij kriteri. <i>Evidenca 18. Syllabuset e lëndëve.</i> <i>Evidenca 31. Analizë e Departamentit mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</i>

<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Gvj konstaton se orët mësimore të modulit “Hyryje në informatikë”, zhvillohen në laboratorin e informatikës (https://unireald.edu.al/laboratoret/#GmediaGallery_2-19), ndërsa orët e praktikave profesionale zhvillohen në kompani/institucione me të cilat KUR ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>KUR nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore. Punimet botohen në “Buletinin Shkencor Reald”, ndërsa punime të tjera i botojnë në revista shkencore të tjera brenda apo jashtë vendit.</p> <p>KUR mbështet stafin akademik me fond të vecantë për kërkimin shkencor.</p> <p>Syllabuset e lëndëve/moduleve të programit të studimit u japin mundësinë studentëve të realizojnë detyra e kursit (apo projektet e kursit), në lëndët/modulet ku ajo është pjesë e planit mësimor. Ato synojnë që të krijojë tek studentët mundësinë për të analizuar një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo dhe të dhëna të cilat mund të sigurohen nga vetë studentët, sipas udhëzimeve të pedagogut.</p> <p><i>Evidenca 26. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për praktikën profesionale</i></p> <p><i>Evidenca 42. Plan masash “Për zbatimin, kontrollin dhe raportimin e detyrave të parashikuara në planin vjetor të institucionit” (për semestrin e dytë, viti akademik 2020 – 2021)</i></p> <p><i>Evidenca 45. Buletini shkencor periodik</i></p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se KUR organizon leksione të hapura duke ftuar folës të jashtëm akademikë ose nga biznesi. Këto leksione ofrojnë mundësi për studentët të zgjerojnë njohuritë e tyre përtej programit.</p> <p>Gjithashtu, në planin e vepritarisë vjetore parashikohet mbajtja e një leksioni të hapur.</p> <p>(https://unireald.edu.al/aktivitete-shkencore/)</p> <p>(https://unireald.edu.al/aktivitete-shkencore/)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Gjatë vizitës në KUR dhe DVV, GVJ konstaton se ka një sërë rregulloresh për rregullat e provimit përfundimtar, punimit të diplomës dhe detyrimet përmbyllëse për finalizimin e studimeve.</p> <p>(Evidenca 5, neni 64 - 66) dhe (Evidenca 7, neni 35, 36). Këto procedura janë transparente dhe të aksesueshme për studentët. (https://unireald.edu.al/wp-content/uploads/2020/04/10.-Rregullore-e-diplomimit.pdf).</p> <p>KUR ka dhe udhëzuesin për hartimin e punimit të diplomës.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVJ konstaton se KUR ka Rregulloren e Diplomimit si dhe Manulain Udhëzues për Temat e Diplomës, në të cilin parashikohen procedurat e asistimit të studentëve nga udhëheqësi gjatë fazave të hartimit e deri në realizimin e diplomës.</p> <p><i>Evidenca 10. Provimet dhe diplomimi i Studenteve</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e Institucionit</i> <i>Evidenca 46. Udhëzues i IAL per hartimin e temës së diplomës</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Nga vizita në KUR u konstatua se komisioni për vlerësimin e provimit final bazohet në pyetje për testimin e njohurive të fituara bazuar në trungun bazë të lëndëve të formimit kurikular për programin e studimit. Mbrotja është e hapur dhe komisioni emërohet nga dekani i fakultetit me propozim të përgjegjësit të njësisë kryesore.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Institucionit</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse</p>	<p>GVJ konstaton se Rregullorja e Institucionit dhe Udhëzuesi për hartimin e temës së diplomës, janë ato të cilat parashikojnë orientimin dhe asistimin e studentëve nga një udhëheqës për punimin e temës së diplomës.</p> <p>Udhëheqësi asiton në të gjitha fazat e kërkimit studentin duke garantuar cilësinë përmes firmës dhe racionit përkatës për tu paraqitur para komisionit të vlerësimit.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Institucionit</i> <i>Evidenca 46. Udhëzues i IAL per hartimin e temës së diplomës</i></p>




punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.									
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Njësia bazë përmes udhëheqësit të miratuar të temës asiston studentët në të gjitha fazat e parashikuara të kërkimit shkencor. <i>Evidenca 46. Udhezues i IAL për hartimin e temës së diplomës</i>								
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë e cila pasqyrohet në procesverbalet përkatëse. Evidenca 5. Rregullore e Institucionit. (neni 64)								
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti me mbarimin e studimeve pajiset me Diplomën dhe Suplementin e diplomës, Listën e notave. Me kërkesën e tyre u vihet në dispozicion edhe një kopje e programit të studimit. Këto dokumenta janë sipas formatit të miratuar nga MAS dhe të paraqitur si evidencë nga institucioni për këtë proces vlerësimi në Evidencën 15 dhe 16. Evidenca 15. Modeli i diplomës Evidenca 16. Modeli i Suplementit të Diplomës								
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga vizita në KUR , GVJ konstaton se të dhënat e studentëve dhe rezultatet e tyre ruhen nga sekretaria mësimore. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentëve dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen. Evidenca 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore (neni 3)								
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

**IV.BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Tituj/gra da	2019-2020		2020-2021		2021 – 2022	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	1	-	1	-	1	-
Prof.As. Dr	2	-	3	1	2	1
Dr/PhD	3	-	2	-	3	-
Msc	<u>5</u>	-	<u>7</u>	-	<u>8</u>	
Në total	11	-	13	1	14	1

Referuar dosjes së vetëvlerësimit, konstatohet se stafi akademik i programit të studimit Bachelor në “Financë”, përmbush kërkesat ligjore, për nivelin e kualifikimit akademik dhe për fushën e ekspertizës. Në këtë program studimi gjate 2021-2022, janë të përfshirë 15 pedagogë gjithsej, ndër të cilët 14 janë staf efektiv (PAE) dhe 1 staf me kontratë (PAK).

Stafi administrativ është në nivel fakulteti, për shkak të numrit të vogël të studentëve.

Evidenca nr. 19. CV-të e stafit akademik të programit të studimit, viti akademik 2022-2023.pdf

Evidenca nr. 21. Të dhëna tabelore për personelin akademik të programit të studimit për 3 vitet e fundit.pdf

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2021-2022	1870	1660	210	89% / 11 %
2020-2021	1870	1795	75	96%/4%

	2019-2020	1870	1795	75	96%/4%
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Duke iu referuar planit mësimor si dhe shpërndarjes së ngarkesës, rezulton se personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën orare si dhe numrin e lëndëve, në zbatim Udhezimin 29 dt 10.09.2018 te MAS. Referuar <i>Dokumenti RVB, Tabela, 12.1, 12.2, 12.3 (ANEKS- Finance 2023..pdf)</i> <i>Ngarkesa totale e stafit akademik të programit të studimit Bachelor në Financë</i>, rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë.</p> <p>Referuar ngarkesës mësimore dhe stafit akademik që e mbulon, per 21-22, rezulton se 89 % mbulohet nga personel akademik efektiv dhe 12 % të ngarkesës totale, mbulohet nga personel akademik me kontratë.</p> <p><i>Evidenca nr. 14. Programi mësimor i studimit - Bachelor nc Financë 2019-2022.pdf</i></p> <p>Evidenca ANEKS- Finance 2023..pdf</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe</p>	<p>GVJ duke u mbështetur në dokumentacionin e DVV si dhe atë të siguruar gjatë vizitës në institucion, konstaton se për tri vite, përgjithësisht nuk ka qarkullim stafi apo largime të stafit, por vihet re shtim i stafit akademik, kryesisht seminaristë pa titull/gradë shkencore. Referuar listëpagesave në DVV si dhe vizitës në institucion, në dosjet e stafit, rezultojnë kontratat e punësimit për stafin akademik si dhe atë joakademik.</p> <p><i>Evidenca nr. 19. CV-të e stafit akademik te programit te studimit, viti akademik 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 21. Të dhëna tabelore për personelin akademik të programit të studimit për 3 vitet e fundit.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 69. Listëpagesa e kontributeve te punonjësve te IAL për vitin 2021.pdf</i></p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konsultoi praktika rekrutimi të cilat, mbështeten në procedura rekrutimi dhe vlerësimi, me kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit. Kriteret si dhe nevojat propozohen nga Departamenti, Dekani i cili i përcjell kërkesën rektorit. Rektori e përcjell kërkesën e fakulteteve senatit për miratim final të kuotave dhe kriterëve përzgjedhëse. Në vijim ato publikohen në webin e institucionit, kur vihet re se janë publikuar njoftime rekrutimi, kriteret si dhe data dhe ora e intervistës. Vlerësimi bëhet mbi procedura të ndara në dy faza, vlerësimi i dosjes dhe intervista. Komisioni miratohet nga rektori. Referuar praktikës së vënë në dispozicion GVJ, konstatohet se</p>				

<p>përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>komisioni ad-hoc i propozon dekanit listen për rekrutim të renditura sipas pikëzimit, së bashku me vlerësimin për secilin. Komisioni propozon renditjen përfundimtare të kandidatëve dhe miratimi bëhet nga rektori. Kontrata lidhet mes fituesit dhe Kryetarit të Bordit të Administrimit.</p> <p><i>Evidenca nr. 74. Praktikë e ZBNJ për rekrutim stafi akademik në IAL, viti akademik 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 11. Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Referuar planit mësimor, ky program nuk ka një natyrë specifike teknike, të mbështetur në orë laborator, por pavarësisht natyrës së programit të studimit Bachelor në “Financë”, nga vizita në institucion dhe nga konsultimi i organogramës së institucionit, rezulton se institucioni garanton staf ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike të programeve të studimit si në orët e lëndës së informatikës, apo të mbështetjes së studentëve gjatë procesit të shkrimit të temave të diplomës.</p> <p><i>Evidenca nr. 66. Organigrama e IAL..pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Referuar dosjes së programit të studimit Bachelor në “Financë” si dhe DVV, GVJ pati në dispozicion informacion për stafin akademik efektiv dhe joefektiv të tre viteve të fundit, ngarkesa e tyre sipas semestrave, lëndët që mbulojnë, Cv-të e tyre si dhe në zyrën e burimeve njerëzore u konsultua informacion dhe i dosjeve të tyre, kualifikimet akademike, kontratat, Cv-të, Librezat e punës etj.</p> <p>Për sa më sipër GVJ është e mendimit që informacioni i kërkuar në këtë kriter është i plotë.</p> <p><i>Evidenca nr. 36. Formati i dosjes personale të stafit akademik dhe Kontrata TIP e punësimit të pedagogut.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 19. CV-të e stafit akademik të programit të studimit, viti akademik 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 21. Të dhëna tabelore për personelin akademik të programit të studimit për 3 vitet e fundit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në</p>	<p>Referuar numrit të vogël të studentëve si dhe marrëveshjeve që Kolegji Universitar “Reald” disponon me kompani dhe institucione në qytetin e Vlorës, GVJ është e mendimit se ky kolegji, nëpërmjet stafit të vet</p>

<p>dispozicion përsonein e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>akademik dhe jo akademik, si dhe mentorëve në biznes, ka kapacitetet për udhëheqjen e studentëve në praktikë si dhe në punimin e diplomës.</p> <p>GVJ vë re nga dokumentacioni si dhe nga vizita në institucion se Kolegji Universitar “Reald”, disponon 16 marrëveshje, kryesisht me biznese në fushën e Hoteleri-Turizmit, sektorin bankar apo Dhomën e Tregtisë.</p> <p>Institucioni rezulton se bën analiza për përfitimet e programit dhe të studentëve nga këto marrëveshje.</p> <p><i>Evidenca nr. 13. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Financë.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 26. Tabelë përmbledhëse e institucioneve bashkëpunuese për kryerjen e praktikës profesionale.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 27. Disa nga marrëveshjet e bashkëpunimit aktiv me aktorët e biznesit për kryerjen e praktikës mësimore.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 28. Raport periodik analitik për kryerjen e praktikës mësimore të studentëve.pdf</i></p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>GVJ konstaton se, marrëveshjet mes Kolegjit Universitar “Reald” dhe institucioneve/kompanive kanë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet e palëve më potenciale për mbikëqyrjen e studentëve në praktika mësimore. Institucionet marrin përsipër të vendosin në dispozicion mjediset e tyre si dhe mentorë për udhëheqjen/mentorimin e studentëve të programit të studimit “Financë”. KUR ndjek me stafin akademik ecurinë e studentëve në praktika duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me mentorët në biznese si dhe me studentët.</p> <p><i>Evidenca nr. 27. Disa nga marrëveshjet e bashkëpunimit aktiv me aktorët e biznesit për kryerjen e praktikës mësimore.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 28. Raport periodik analitik për kryerjen e praktikës mësimore të studentëve.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe në vizitën në Kolegjin Universitar “Reald”, vlerëson se personeli akademik që mbulon programin e studimit bachelor në “Financë”, përmbush standardet sasiore dhe cilësore. Kolegji, dëshmon se ka numrin e duhur dhe me kualifikimin e duhur e të posaçëm të stafit akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Institucioni, ndjek praktika rekrutimi dhe vlerësimi mbështetur në rregulloren e institucionit dhe i bën ato transparente.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ duke konsultuar dokumentacionin për infrastrukturën si dhe nga vizita në mjediset e KUR, konstaton se mjediset janë të përshtatshme për zhvillimin e leksioneve/seminareve. KUR rezulton se e zhvillon veprimtarinë e vet në dy godina, A me sipërfaqe 3066 m², e shtrirë në tre kate dhe B me sipërfaqe 2600 m². Godinat janë strukturuar në salla leksionesh, seminaresh, zyra, laboratore, mjedise shlodhëse etj. Godina A rezulton të ketë 17 salla leksionesh dhe seminaresh, 1 sallë konference si dhe 7 laboratore dhe kabinete profesionale sipas programeve të studimit. Biblioteka, sekretaria, zyrat si dhe ambjentet shlodhse janë në këtë godinë.</p> <p><i>Evidenca nr. 34. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Referuar vizitës në institucion, konstatohen se klasat dhe laboratorët janë me kapacitete të mjaftueshme, përgjithësisht rezultonin të pajisura me videoprojektorë, white board, PC dhe si rrjet kabllor internet, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p><i>Evidenca nr. 34. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në mjediset e KUR, rezulton se sallat e leksioneve dhe seminareve, si dhe laboratorët, kanë pajisjet e teknologjisë së informacionit, kompjutera dhe softet që i shërbejnë plotësimin të objektivave të programit, për realizimin e detyrave, prezantimeve audiovizive apo për përpunimet kompjuterike, në përputhje me natyrën e lëndëve të programit të studimit bachelor në Financë. Biblioteka gjithashtu rezulton me pajisur me 20 kompjutera.</p>

formues të programit të studimit në tërësi.	<i>Evidenca nr. 34. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.pdf</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Referuar evidencës infrastrukturore, rezultojnë 7 laboratorë disponibël ose kabinete, por që kryesisht janë për programet e studimit të shkencave të jetës. Për programet e studimit me natyrë ekonomike, KUR vendos në dispozicion një laborator informatike. Gjatë vizitës në institucion konstatohen se laboratorët kanë pajisjet e teknologjisë së informacionit, kompjutera dhe softë që përputhen me natyrën e lëndëve specifike të programit të studimit bachelor në Financë, që i shërbejnë jo vetëm lëndës së informatikës, por edhe lëndëve të tjera si kontabilitetit etj. <i>Evidenca nr. 34. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.pdf</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se KUR vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit Bachelor në "Financë", si dhe për formimin praktik të studentëve të këtij programi. Këto mjedise garantojnë kapacitetet e duhura fizike, laboratorike dhe me pajisjet e duhura për procese mësimdhënëse cilësore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ konsultoi syllabuset e lëndëve, vizitoi bibliotekën e institucionit si dhe komunikoi me stafin dhe studentët gjatë vizitës në institucion nga ku rezultoi se në dispozicion të studentëve është vendosur literatura bazë dhe ndihmëse në shërbim të njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Kjo literaturë është në gjuhën shqipe dhe angleze. Burimet e saj gjenden fizikisht si dhe në bibliotekat elektronike qe institucioni ka mundur të mundësuar. <i>Evidenca nr. 37. Lista e teksteve në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.pdf</i>

	<p><i>Evidenca nr. 18. Syllabuset e lëndëve Bachelor në Financë. 2022-2023.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Referuar dosjes së vetëvlerësimit rezulton se literatura në programet e lëndëve është kryesisht në gjuhën shqipe, ka libra universitarë në përputhje me programin.</p> <p><i>GVJ sugjeron që departamenti të azhurnojë literaturën në syllabuse sipas kërkesave të VKM 41 të ndryshuar e të vijojë me kërkesat për azhurnimin edhe të bibliotekës me këto tituj më të fundit. Biblioteka pasurohet në vijueshmëri. Mbështetje për pasurimin e bibliotekës dhe mundësive për literaturë është edhe regjistrimi në Jstor dhe mundësia për të shfrytëzuar fondin e publikimeve në Jstor nga stafi dhe studentët.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 37. Lista e teksteve në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 18. Syllabuset e lëndëve Bachelor në Financë. 2022-2023.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>KUR vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore. Kjo bibliotekë është në shërbim për studentët e të gjitha njësive kryesore që IAL ka. Referuar Evidencave për infrastrukturën e KUR, biblioteka është e pajisur me softë dhe me 20 PC.</p> <p>Biblioteka ka një orar të përshtatshëm që siguron shfrytëzim të mirë nga studentët e programit nga e hëna në të shtunë, 08.00-16.00.</p> <p><i>Evidenca nr. 37. Lista e teksteve në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar fondit të librit si dhe kapacitetit të bibliotekës rezulton se ajo është e pajisur me fond fizik librash në mbështetje të programit të studimit bachelor në AB, si literaturë bazë dhe ndihmëse dhe revista shkencore në periodikë të fushave të ndryshme.</p> <p>Në këtë fond të literaturës, janë librat bazë për lëndët e PS bachelor në Financë, si dhe literatura ndihmëse, shqip ose anglisht, sipas programit të lëndëve. <i>Pavarësisht kësaj është e nevojshme azhurnimi i bibliotekës me literaturë fizike të përditësuar.</i></p> <p>Lista e librave mund të konsultohet online nëpërmjet webit të institucionit. GVJ nuk konstatoi nga dokumentacioni dhe as nga vizita në institucion mundësi shfrytëzimi të bibliotekave elektronike.</p> <p><i>Për sa më sipër, GVJ sugjeron që institucioni të mundesojë regjistrimin në biblioteka elektronike si U-Library, Jstor apo të tjera, si mundësi për stafin akademik dhe studentët, për të pasur në dispozicion më shumë tituj se çfarë mund të ketë biblioteka fizike e për më tepër titujt</i></p>

	<p><i>më të kohës si mundësi për hulumtimet e materialeve për lëndët si dhe për zhvillimin e temës së diplomës.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 37. Lista e teksteve në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ofron kushte për shfrytëzim dhe akses të barabartë të fondit fizik dhe pa pagesë për studentët e kësaj njësie kryesore. Nga vizita në institucion rezulton se mjediset e bibliotekës janë në dispozicion të studentëve jo vetëm për shfrytëzimin e fondit të librit, por edhe si sallë studimi gjatë semestrit apo sezoneve të provimeve.</p> <p><i>Evidenca nr. 37. Lista e teksteve në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Referuar evidencës infrastrukturore të bibliotekës si dhe vizitës në institucion salla e bibliotekës është e pajisur me 20 PC dhe disa pajisje të tjera si skaner e fotokopje. Studentët mund të përdorin dhe katalogun elektronik të bibliotekës.</p> <p><i>Evidenca nr. 37. Lista e teksteve në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Referuar RVB si dhe vizitës në institucion, biblioteka funksionon në orare zyrtare 08-16.00, nga e hëna në të shtunë në shërbim të studentëve dhe stafit akademik. Mësimi në programin e studimit bachelor në Financë, zhvillohet nga e hëna në të premte, ndërkohë që orari i bibliotekës është më i shtrirë në kohë dhe krijon mundësi shfrytëzimi të mirë nga studentët e këtij programi.</p> <p><i>Evidenca nr. 37. Lista e teksteve në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli</p>	<p>GVJ konstatoi në dosjen e vetëvlerësimit të bachelor në Financë se funksionimi i bibliotekës, pasurimi i saj dhe cilësia e fondit të librit është pjesë e analizës vjetore të institucionit.</p> <p><i>Pavarësisht për sa më sipër, GVJ sugjeron shtimin e fondit fizik të librit në gjuhën shqipe dhe përditësimin e saj, në përputhje me programin e studimit dhe sugjeron që kërkesat për libra të bëhen periodikisht nga stafi i departamentit si dhe të kenë një fond të parashikuar në buxhet për pasurimin e përvitshëm të bibliotekës.</i></p>

<p>akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p><i>Evidenca nr. 37. Lista e teksteve në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se kushtet fizike infrastrukturore të bibliotekës së KUR, janë të përshtatshme për t'ju shërbyer kapaciteteve dhe kërkesave të studentëve dhe stafit akademik. GVJ sugjeron shtimin e fondit fizik dhe regjistrim në biblioteka elektronike të akseueshme nga stafi dhe studentët. GVJ sugjeron pasurimin dhe përditësimin e fondit të bibliotekës fizike me botimet e fundit të titujve në përputhje me programin e studimit bachelor në Financë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi IV.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB, vizitës në sekretarinë mesimore si dhe Evidencave të DVV, GVJ konstaton se KUR disponon një Sistem të Manaxhimit të Informacionit, SMI, që siguron akses për këta përdorues: studentët, stafin akademik, sekretaritë si dhe zyrën e IT. Sistemi i Manaxhimit të informacionit SMI, është një sistem elektronik, që administron informacionin nga regjistrimi deri në dalje, për studentët e programit.</p> <p>Përveç dokumentacionit letër të disponueshëm ne zyrat e KUR, ky sistem elektronik i manaxhimit të informacionit, krijon mundësi aksesi në informacionin e vlerësimit të studentëve, akses për studentet, stafin akademik dhe zyrat mbështetëse të institucionit.</p>

<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>GVJ konstaton se përveç sistemit elektronik SMI, për stafin dhe studentët informacioni mbahet edhe në formë shkresore. Për studentët informacioni përveçse në sistem, rezulton i ruajtur edhe nëpërmjet regjistrit themeltar, regjistrin të përparimit akademik të studentëve, si dhe regjistrin të lëshimit të diplomave. Këto regjistra u konsultuan nga GVJ gjatë vizitës në institucion dhe rezultuan me informacion e plotë të kërkuar.</p> <p><i>Evidenca nr. 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 38. Rregullore e strukturës së Teknologjisë së Informacionit (SMI).pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 64. Regjistër i notave - Bachelor në Financë.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 65. Amza - Bachelor në Financë.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar përdorimit të sistemit, GVJ konstatoi se sistemi SMI, ka hapësirën virtuale të çdo pedagogu/lënde, për komunikim interaktiv me studentët. Përveç sistemit, institucioni për komunikim interaktiv dhe zhvillim të mësimin online ka përdorur platforma elektronike si Google Meet etj</p> <p><i>Evidenca nr. 38. Rregullore e strukturës së Teknologjisë së Informacionit (SMI).pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 60. Urdhër për zhvillimin e mësimin ONLINE. Viti akademik 2020 - 2021.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ nga vizita në sekretarinë e KUR, dhe konsultimit të dokumentacionit konstaton se përveç formës shkresore të ruajtjes së informacionit në regjistra, institucioni ka sistemin elektronik SMI që u demonstrua për GVJ dhe që me kapacitetin që ka, mendojmë se ndihmon të ofrojë në mënyrë efektive dhe koherente informacion për studentët dhe vlerësimet e tyre, procesverbalet e lëndëve të ndryshme, mundësi komunikimi interaktiv mes studentëve dhe stafit akademik, lehtësi në manaxhimin e informacionit për sekretaritë etj.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Përdoruesit e sistemit rezultojnë të kenë akses të dedikuar në sistem nëpërmjet kredencialeve të tyre personale, nga vizita në institucion rezultoi se stafi akademik informon studentët për rezultatet, nëpërmjet sistemit, studentët informohen në kohë reale për to.</p> <p>Sistemi elektronik i informacionit SMI, rezulton një sistem i integruar me platforma dhe module që suportojnë komunikimin interaktiv mes studentëve dhe stafit akademik, duke e bërë komunikimin mes tyre më efektiv. <i>Pavaresisht potencialit që sistemi ka, GVJ sugjeron që institucioni të sensibilizojë studentët kryesisht, por edhe stafin akademik për përdorimin e sistemit dhe minimizimin e formave tradicionale të komunikimit me studentët, të notave, ankimeve apo</i></p>

	<i>informacioneve të tjera, dhe përforcimin rutinor të përdorimit të sistemit prej tyre.</i>			
	<i>Evidenca nr. 38. Rregullore e strukturës së Teknologjisë së Informacionit (SMI).pdf</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	KUR ka një faqe interneti me informacion të përmbledhur për të gjitha njësitë kryesore, si dhe informacion që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme të njësive të tjera. Faqja zyrtare është në tre gjuhë: shqip, italisht dhe anglisht. Në faqen zyrtare ofrohet mundësi aksesit për përdoruesit e brendshëm me anë të kredencialeve personale. <i>Evidenca nr. 39. Të dhëna nga faqja WEB.pdf</i>			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstaton se në zbatim të legjislacionit në fuqi, KUR, harton një raport vjetor. Referuar DVV, pjesë e këtij raporti rezulton të jetë edhe raportimi financiar i cili kalon për miratim në bordin e Administrimit. GVJ konstatoi se institucioni ka hartuar një raport të analizës së kostove të programeve të studimit, ku paraqet informacionin për zërat e kostove dhe nivelet e tyre, ku 50% e tyre e zënë shpenzimet e pagave. Në këtë raport konstatohen edhe strategjitë për financimin e këtyre shpenzimeve. <i>Evidenca nr. 41. Të dhëna nga Raporti financiar vjetor i IAL që lidhet me kostot e programit të studimit.pdf</i> <i>Evidenca nr. 69. Listëpagesa e kontributeve të punonjësve të IAL për vitin 2021.pdf</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e	Referuar RVB dhe DVV, rezulton se raporti financiar paraqet informacion për zërat që do të financohen dhe nga çfarë burimesh financohen, politika e pagave, politika e bursave të meritës apo bursave sociale që KUR ndjek etj. Në raport jepen shpenzimet e planifikuara

<p>burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>për financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për këshillat studentore etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 41. Të dhëna nga Raporti financiar vjetor i IAL që lidhet me kostot e programit të studimit.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 75. Vendim i BA për trajtimin e studenteve me status të veçantë dhe miratimin e bursave..pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 52. Vendim i BA për miratim fondi për Keshillin Studentor.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ referuar RVB dhe DVV, konstaton se raporti për buxhetin dhe realizimin e tij është i detajuar deri në nivel njësie bazë përgjegjëse.</p> <p>Ne këtë raport pasqyrohen zërat e shpenzimeve, nivelet e tyre, të ardhurat dhe burimet e tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Konstatohen në këtë raport zëra të financimit të mbështetjes studentore, për bursa ose për këshillat studentore.</p> <p><i>Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Referuar RVB si dhe DVV, rezulton se KUR i siguron të ardhurat nga tarifata të studentëve.</p> <p>Gjithashtu GVJ konsultoi edhe listëpagesat për stafin, çfarë demonstroi aftësinë për të paguar detyrimet ndaj stafit të institucionit.</p> <p><i>Pavarësisht sa më sipër, në kushtet e zvogëlimit të numrit të studentëve, GVJ sugjeron, se KUR duhet të sigurojë forma alternative të gjenerimit të fondeve në të ardhmen nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare etj.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 69. Listëpagesa e kontributeve të punonjësve të IAL për vitin 2021.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 68. Listëpagesa e kontributeve të punonjësve të IAL për vitin 2020.pdf</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ konstaton se KUR, harton dhe miraton buxhete vjetore si dhe raporton realizimin e tij dhe raporton e analizon kostot e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V.STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ konstaton se KUR ka një sërë rregulloresh dhe procedurash duke filluar nga niveli institucional në tërësi e deri tek departamenti apo programi i studimit që mbulojnë një cikël të plotë të Bachelor në Financë, nga hyrja deri në diplomim të studentëve në Bachelor në Financë. Këto procedura janë të sanksionuara respektivisht në <i>nenin 37-73 të rregullores së institucionit</i> , si dhe në Strategjinë e zhvillimit të KUR, ku ndër objektivat e kësaj strategjie gjenden edhe objektivat specifike për mesimdhënie dhe mësimnxënie me në qendër studentin. <i>(pika 7 e strategjisë)</i> <i>Evidenca nr. 3. Strategjia e Zhvillimit Institucional 2021 - 2026.pdf</i> <i>Evidenca nr. 5. Rregullore e përgjithshme e IAL - e ndryshuar.pdf</i> <i>Evidenca nr.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë.pdf</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton se dokumentet strategjike të KUR, si strategjia e institucionit <i>pika 7</i> , rregullore e institucionit, rregullore e fakultetit <i>neni 44</i> , rregullore e programit, fokusohen në trajtimin e barabartë dhe sipas meritokracisë, referuar procedurave të përzgjedhjes së studentëve si dhe atyre të vlerësimit të avancimit akademik të tyre. <i>Evidenca nr. 6. Rregullore e njësive kryesore FE.pdf</i>

<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Referuar takimeve me drejtues së njësisë kryesore dhe asaj bazë, webit zyrtar si dhe DVV, rezulton se institucioni publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme që duhet të plotësojnë kandidatët për t'u pranuar në Bachelor në Financë. Këto kritere miratohen nga senati akademik dhe publikohen në faqen zyrtare.</p> <p>Referuar vendimit të senatit për kriteret e vitit akademik 2022-2023 dhe 2023-2024, aksesuar nga GVJ në faqen zyrtare të internetit, rezulton se kriteret janë vetëm kritere të përgjithshme dhe konkretisht nota mesatare e shkollës së mesme, sipas bazës ligjore.</p> <p>Linku ne vijim : Kriteret e Pranimit - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al)</p> <p><i>(Vendim-Senati-nr.-1-dt.-08.01.2021-Miratim-kriteret-e-pranimit-te-studenteve-2022-2023-1.pdf (unireald.edu.al))</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe procedurat e pranimit së studentëve janë të publikuara në webin zyrtar të KUR dhe mund të aksesohen nga të gjithë të interesuarit. Informacioni në web ofrohet edhe për mundësitë e përfitimit të bursës, transferimet, oraret mësimore si dhe për kalendarin e provimeve. Informacioni në web për studentet është i plotë dhe jepet në tri gjuhë: shqip, italisht dhe anglisht. Më poshtë linqet e konsultura nga GVJ për këtë kriter.</p> <p><i>(Vendim-Senati-nr.-1-dt.-08.01.2021-Miratim-kriteret-e-pranimit-te-studenteve-2022-2023-1.pdf (unireald.edu.al ; Kohëzgjatja e studimeve - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al); Mbrojtja e diplomës - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al); Transferime dhe ekuivalentime - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al))</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ duke iu referuar DVV si dhe webit të instituconit, konstaton se Kolegji Universitar Reald, realizon informimin e publikut për kërkesat e pranimit në Bachelor në Financë nëpërmjet webit të institucionit, ku publikohen vendimet e senatit akademik të institucionit rreth kriterëve të pranimit. Institucioni sensibilizon publikun edhe për mundësinë e përfitimit të bursës së meritës apo për shtresa të margjinalizuara.</p> <p><i>(Vendim-Senati-nr.-1-dt.-08.01.2021-Miratim-kriteret-e-pranimit-te-studenteve-2022-2023-1.pdf (unireald.edu.al)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.</p>	<p>Referuar dokumentacionit si dhe takimit me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, ata propozojnë kriteret dhe kuotat për PS bachelor në Financë, të cilat miratohen nga senati akademik si dhe nga bordi i administrimit dhe i përcillen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Përcaktimi i kriterëve për shtresat e margjinalizuara si dhe për kandidatët nga shtete të tjera, mbështeten në udhëzimet e MAS.</p>

	<p>Për sa më sipër, GVJ konsultoi webin e institucionit dhe konstaton se institucioni i publikon në faqen zyrtare, kriteret për pranimin në programet e studimit.</p> <p><i>(Vendim-Senati-nr.-1-dt.-08.01.2021-Miratim-kriteret-e-pranimit-te-studenteve-2022-2023-1.pdf (unireald.edu.al)</i></p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Referuar njoftimeve në faqen zyrtare të institucionit, rezulton se kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e tjera si dhe kuotat për ta janë hartuar në përputhje me udhëzimin e MAS nga departamenti, janë miratuar nga senati akademik dhe bordi i administrimit i KUR, si dhe janë publikuar për informim të gjerë të palëve të interesuara. Fokusi i këtyre kriterëve, vendoset tek mesatarja e shkollës së mesme.</p> <p><i>(Vendim-Senati-nr.-1-dt.-08.01.2021-Miratim-kriteret-e-pranimit-te-studenteve-2022-2023-1.pdf (unireald.edu.al)</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Referuar faqes zyrtare të internetit të institucionit si dhe DVV, GVJ konstaton se institucioni ofron informacion të plotë për përfitimin e bursave, në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Këto bursa parqiten si bursa merite ose bursa financiare apo përjashtim nga pagesat e tarifave për shtresat në nevojë në përputhje me vendimet që Bordi i Administrimit merr. Në DVV institucioni vendos në dispozicion edhe vendime të BOA për bursat. Në këtë vendim GVJ konstaton se për 2022-23, bursat janë 100% për studentët ekselentë me mesatare 10 dhe 50% bursë për studentët e komunitetit romë-egjiptian apo që janë me aftësi ndryshe.</p> <p><i>Evidenca nr. 75. Vendim i BA për trajtimin e studentëve me status të veçantë dhe miratimin e bursave..pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, mbështetur në dokumentacion në DVV si dhe nga vizita në institucion, është e mendimit se institucioni, harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit Bachelor në Financë. Këto gjenden në rregulloren e institucionit, të fakultetit, të programit si dhe ato publikohen e janë të aksesueshme në web e institucionit në tre gjuhë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nga vizita në institucion si dhe nga DVV, GVJ konstaton se KUR ofron informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret që duhet të ndiqen dhe procedurat e zbatuara për përparimin akademik të studentëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet rregullatore të brendshme, rregulloren e institucionit <i>neni 42</i>, të njësisë kryesore si dhe të programit bachelor në Financë. GVJ vlerëson se ky informim bëhet në forma alternative, nëpërmjet sekretarisë mësimore, nëpërmjet zyrës së kvshillimit si dhe nëpërmjet webit të fakultetit.</p> <p><i>Evidenca nr. 7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Financë.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 6. Rregullore e njësisë kryesore FE.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 5. Rregullore e përgjithshme e IAL - e ndryshuar.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se KUR në faqen zyrtare publikon kriteret për transferimet për informim të gjerë, gjithashtu nga takimi me studentët rezulton se informohen parimisht nëpërmjet akteve të cituara në kriterin më sipër dhe të publikuara në faqen zyrtare të internetit, por ata preferonin më tepër informimin fizikisht, nëpërmjet zyrës së këshillimit dhe karrierës, sekretarisë mësimore dhe departamentit të Financës.</p> <p><i>Transferime dhe ekuivalentime - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Referuar DVV, por edhe takimeve me studentët e programit si dhe stafin e programit, GVJ konstaton nga takimet me stafin dhe studentët, se ata informohen nga pedagogët e çdo lënde në orën e parë të semestrit për syllabuset, detyrimet lëndore, kriteret e vlerësimit, etj. këto kritere janë pjesë të rregullores së institucionit dhe të rregullores së programit që gjithashtu rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare të IAL.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Për GVJ rezulton se informimi për punimin e diplomës bëhet nga udhëheqësit e studentëve dhe nëpërmjet Udhëzuesit të punimit të diplomës si dhe nëpërmjet sekretarive për afatet dhe detyrimet që duhen përmbushur para diplomimit. Përveç kesaj, institucioni ka rregulluar me akt të posaçëm regulativ procesin e diplomimit dhe informon studentet nëpërmjet webit si dhe stafit akademik apo</p>

	<p>administrativ për detyrimet që kanë sipas kësaj rregulloreje të diplomimit.</p> <p><i>Evidenca nr. 46. Udhëzuesi për punimin e temës së diplomës.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 10. Rregullore e Diplomimit të Studentëve.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Rezulton nga DVV se institucioni organizon ditë informuese dhe orientuese për student të ardhshëm të programit në shkollat e mesme kryesisht të qytetit të Vlorës. Të interesuarit informohen edhe me anë të mesazheve promocionale që jepen në mediat locale si dhe nepërmjet shpërndarjes së posterave.</p> <p><i>Evidenca nr. 39. Të dhëna nga faqja WEB.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 40. Poster për informimin e publikimit të informacionit për programet që ofron IAL.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni ofron mundësi informimi për studentët për kriteret e vlerësimit, kuotat, transferimet, për detyrimet lëndore, për punimin e temës së diplomës si dhe informim për studentët e ardhshëm.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni informon studentët me informacion të plotë lidhur me programin. Ky informacion konsiston, në kohëzgjatjen e programit, strukturën e çdo semestri, formën e organizimit, detyrimet që studentët kanë etj.</p> <p>GVJ konstatoi se ky informim realizohet nga departamenti dhe stafi akademik nepërmjet syllabuseve, strukturat e sekretarisë mësimore si dhe zyra e Këshillimit dhe Karrierës për orarin mesimor si dhe për kalendarin e provimeve etj. Studentët rezulton se informohen gjithashtu në distancë nepërmjet faqes zyrtare, videove promovuese dhe broshurave që paraqesin informacion për programin e studimit bachelor ne Financë.</p>

	<p><i>Evidenca nr. 59. Kalendari i zhvillimit të provimeve.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 18. Syllabuset e lëndëve Bachelor në Financë. 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 58. Orari mësimor.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstaton se gjatë takimeve me drejtues të njësisë bazë, me stafin e programit dhe studentët e PS në Bachelor në Financë, se çdo pedagog gjatë javës së parë të çdo viti, informon në mënyrë specifike për studentët për lëndën, syllabusin, literaturën dhe detyrimet akademike të çdo lënde, format dhe skemat e vlerësimit që janë të sanksionuara në rregullore dhe në syllabuse, etj</p> <p><i>Evidenca nr. 18. Syllabuset e lëndëve Bachelor në Financë. 2022-2023.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi me përfaqësues të zyrës së Këshillimit të karrierës, dhe Alumnit, rezulton se kjo zyrë zhvillon aktivitete për orientimin në tregun e punës, por këto aktivitete deri tani rezultojnë të pakta dhe sporadike.</p> <p><i>GVJ rekomandon që aktiviteti i zyrës së Këshillimit të karrierës, dhe Alumnit të jetë më i organizuar, më vizibël, më aktiv, më frekuent, mbështetur në aktivitete të përshatura me nevojat e studentëve, sipas programeve të studimit, për të rritur mbështetjen institucionale për orientimin në tregun e punës të studentëve.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 24. Të dhëna përmbledhëse për punësimin real të studentëve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët rezultojnë të informuar rreth procesit mësimor, lëndëve, programeve, formave të vlerësimit, infrastrukturës në shërbim të tyre etj.</p> <p>Rezultoi se institucioni realizon edhe ditë të hapura për studentët e rinj sipas një kalendari informues, jo vetëm për procesin mesimor por edhe për aktivitete të tjera dhe shërbimet që ofrojnë zyrat mbështetëse.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë</p>	<p>GVJ konstaton gjatë vizitës në institucion, se sistemi elektronik mundëson akses në informacion lidhur me procesin mësimor, syllabuset, leksionet e parashkruara apo prezantimet në powerpoint në hapësirën e pedagogut, detyrimet lëndore, oraret e mësimit dhe kalendarin e provimeve, vlerësimin e çdo lënde etj.</p>

lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Gjithashtu për studentet e ardhshëm apo për publikun e gjerë, një pjesë esenciale e këtij informacioni konstatohet se ofrohet edhe nepërmjet webit zyrtar në tre gjuhë: shqip, italisht dhe anglisht. <u>home - Collegio Universitario REALD (unireald.edu.al)</u>			
Konkluzione	<i>GVJ është e mendimit se institucioni informon për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet nëpërmjet sekretarisë mësimore, stafit akademik si dhe faqes zyrtare të internetit në tri gjuhë. GVJ është e mendimit se institucioni duhet të ketë një aktivitet më efektiv të zyrës së këshillimit dhe karrierës për mundësitë e punësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe nga takimet me drejtues të njësisë bazë dhe me sekretarinë, konstaton se KUR harton dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në PS Bachelor në Financë. Referuar regjistrave themeltar nga vizita në institucion si dhe Evidences 23, rezulton se numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, për vitin akademik është: 2020-2021 7 studentë; 2021-2022 10 studentë; 2022-2023 11 studentë.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e	GVJ referuar të dhënave dhe regjistrave që institucioni mban, konstaton se KUR mban të dhëna të vazhdueshme për ecurinë e studentëve deri në diplomim, vlerësimet e tyre në çdo lëndë, regjistrime këto që përveç procesverbaleve analitike të çdo lënde në hard copy, hidhen edhe në

<p>tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>regjistrat themeltar ku çdo student rezulton i regjistruar dhe është pajisur me numer matrikullimi.</p> <p>Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të regjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e shkollës së mesme, listë notash, fotokopje e kartës së identitetit, mandatë pagesë, etj</p> <p><i>Evidenca nr. 23. Të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar në programin Bachelor në Financë, në 3 vitet e fundit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstatoi se, të dhënat për studentët si regjistrimet, vlerësimet e çdo lënde, detyrimet akademike të studentëve, mbahen manualisht ne sekretarine e KUR, si dhe në mënyrë elektronike në sistemin e informacionit nga sekretaria, sipas procedurave që parashikohen në për këtë sistem.</p> <p>Këto forma të kombinuara të mbajtjes së të dhënave, fizikisht dhe elektronikisht, GVJ i vlerëson pozitivisht, sepse rrisin sigurinë e ruajtjes së të dhënave, por edhe shpejtësinë e sigurimit të informacionit nga përdoruesit e autorizuar të sistemit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njërive përgjegjëse për Financën (sekretaritë mësimore, sistemin e Financës të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar, konstaton se proceset mbikëqyrëse si dhe strukturat që kanë përgjegjësinë e kryerjes së proceseve mbikëqyrëse dhe të monitorimit janë të sanksionuara në rregulloren e institucionit. këto përgjegjësi ushtrohen nga strukturat e departamentit apo fakultetit.</p> <p><i>Evidenca nr. 23. Të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar në programin Bachelor në Financë, në 3 vitet e fundit.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 2. Statuti i Kolegjit Universitar REALD.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>KUR disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi (mesataren në hyrje dhe në dalje), deri në diplomimin e tyre dhe rezulton se i analizon ato në analizat vjetore. GVJ mbështetur në DVV, konstatoi se këto të dhëna bëhen pjesë e analizës së departamentit dhe raportit vjetor në nivel institucioni dhe shoqërohen me plan masash. <i>GVJ sugjeron, që institucioni duhet të intensifikojë përpjekjet për rritjen e numrit të studenteve të regjistruar në programin e studimit bachelor në Financë si dhe të cilësisë së tyre,</i></p> <p><i>Evidenca nr. 31. Analizë e Departamentit për arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.pdf</i></p>

	<p><i>Evidenca nr. 17. Raporti vjetor 2021-2022 dhe shkresa përcjellëse në MAS.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 42. Plan masash për zbatimin, kontrollin dhe raportimin e detyrave të parashikuara në planin vjetor të IAL.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ gjykon se institucioni administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit Bachelor në Financë, nga pranimi deri në diplomim.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron, që institucioni duhet të intensifikojë përpjekjet për rritjen e numrit të studentëve të regjistruar në programin e studimit bachelor në Financë si dhe të cilësisë së tyre.</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	E drejta për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese është e sanksionuar në LAL 80/2015, dhe në Statutin e KUR neni 10. GVJ konstatoi nga RVB dhe nga informacioni në DVV se studentët janë të përfaqësuar në njësinë e Sigurimit të Cilësisë, senatin akademik, në grupin e vlerësimit të brendshëm institucional dhe GVB. Gjithashtu studentët kanë krijuar këshillat studentore për të cilët rezultojnë që institucioni i mbështet me financim si dhe me infrastrukturë që të funksionojnë.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin	Referuar dosjes së vetëvlerësimit, studentët rezultojnë pjesë e komisioneve të vetëvlerësimit të institucional dhe programor. Pjesëmarrja e tyre në këto procese të vlerësimit të brendshëm, krijon mundësinë që studentët të përcjellin perceptimin e tyre, sugjerimet e tyre për proceset mësimore, funksionimin e strukturave të institucionit etj.

<p>akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Studentët përcjellin mendimet e tyre edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në anketimin që bëhet çdo semestër për vlerësimin e procesit akademik dhe të infrastruktures së institucionit.</p> <p><i>Evidenca nr. 32. Pyetëtori i studenteve.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 48. Pyetësor që plotësohet nga studentet, për kushtet në IAL.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Nga takimi me drejtues të njësisë bazë, rezultoi se përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit mësimor në Bachelor në Financë, është indirekt nëpërmjet feedbackut që njësia bazë merr prej pyetësorit të studentëve që zhvillohen dy herë në vit nga NJSBC, si dhe nëpërmjet përfshirjes së tyre në GVB.</p> <p>GVJ vlerëson përfshirjen e studentëve në anketat e zhvilluar për vlerësimin e procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca nr. 8. Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 56. Urdhër i Rektorit për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm për hartimin e RVB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët kanë të sanksionuar në rregullore, të drejtën e ankimit si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre. Referuar takimeve me stafin akademik dhe me studentët, studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit, konsultimit me tezën e provimit e më pas pedagogu i lëndës vendos notën përfundimtare. Nëse studenti sërish e ankimon këtë rezultat, i drejtohet me shkrim përgjegjësit të departamentit, për të ngritur një komision të ri për rishikimin e rezultatit.</p> <p>Gjithashtu nëpërmjet anketimeve semestrale, studentët kanë të drejtë të shprehin perceptimet e tyre mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.</p> <p><i>Evidenca nr. 32. Pyetëtori i studentëve.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 48. Pyetësor që plotësohet nga studentët, për kushtet në IAL.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ është e mendimit se studentët rezultojnë të përfaqësuar në një sërë komisionesh dhe strukturash vendimarrëse, por referuar takimeve me studentët, GVJ sugjeron që institucioni të nxisë një angazhim më proaktiv të tyre.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se KUR nëpërmjet njësive të posaçme në strukturën organizative, zhvillon procedura në shërbim të informimit të studentëve mbështetur në statutin edhe rregulloren e tij. Përsa më sipër është zyra e Këshillimit dhe Karrierës dhe sekretaria mesimore, të cilët në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe atë bazë, informojnë studentët.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se KUR ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën</p>	<p>Referuar Statutit dhe Rregullores së institucionit janë të sanksionuara detyrat që zyra e Këshillimit, Karrierës dhe Alumnit duhet të kryejnë. GVJ konstatoi aktivitete informimi me maturantët të kryer nga kjo zyrë mbi bazën e një kalendari paraprak, aktivitete informimi për studentët e vitit të parë.</p> <p><i>Pavarësisht për sa më sipër, GVJ sugjeron se zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, duhet të planifikojë dhe të organizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe më të shpeshtë, aktivitete informuese dhe orientuese për studentët, në lidhje me internshipe pranë kompanive dhe për punësimin e tyre të ardhshëm këto aktivitete sugjerohen të jenë më të organizuara, të formalizuara dhe më të gjurmueshme.</i></p>

profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	GVJ konstatoi se KUR ka krijuar Rrjetin Alumni, ku vihet re se numri i ish-studentëve të programit të studimit bachelor në Financë, në Alumni është ende i vogël. GVJ konstatoi se institucioni mban statistika të punësimit të studentëve që kanë mbaruar Bachelor në Financë. <i>Evidenca nr. 24. Të dhëna përmbledhese për punësimin real të studentëve.pdf</i>			
Konkluzione	<i>GVJ është e mendimit se institucioni duhet të rrisë efektivitetin e zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, për të siguruar një lidhje më të mirë me tregun e punës dhe një orientim më të mirë të studentëve dhe gjurmim më të plotë të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ referuar dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimeve me stafin akademik dhe drejtues të programit, konstaton se institucioni në kushtet e mësimi në distancë për shkak të pandemisë, ka hartuar dhe publikuar një udhëzues në nivel institucional për mësimdhënien online, për t'u përshtatur me kushtet e reja mjedisore.</p> <p><i>Evidenca nr. 60. Urdhër për zhvillimin e mësimi ONLINE. Viti akademik 2020 - 2021.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 63. Google Classroom - Manual për pedagogët.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 61. Google Classroom - Manual për studentët.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 60. Urdhër i Rektorit për zhvillimin e mësimi ONLINE.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Referuar vizitës në institucion dhe takimeve me strukturat drejtuese dhe mbështetëse, GVJ konstaton se strukturat e njësisë bazë, njësisë kryesore përgjegjëse për programin si dhe njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zbatojnë disa instrumenta të monitorimit të mësimdhënies, si kontrole të zhvillimit të mësimi, aplikimin e pyetësorëve si instrument i vlerësimit të procesit të mësimdhënies, vlerësimit të performancës së stafit akademik në disa fusha, pyetësorëve për vlerësimin e infrastrukturës së KUR etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 48. Pyetësor që plotësohet nga studentët, për kushtet në IAL.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 33. Pyetësor i stafit akademik dhe ndihmës akademik.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 32. Pyetësori i studentëve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit si dhe me stafin e zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rezulton se pyetësori zhvillohet para përfundimit të çdo semestri dhe synon përfshirjen e të gjithë studentëve të programit për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, format alternative të saj, vlerësimin e dijeve etj.</p> <p><i>Evidenca nr. 48. Pyetësor që plotësohet nga studentët, për kushtet në IAL.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 33. Pyetësor i stafit akademik dhe ndihmës akademik.pdf</i></p>

	<i>Evidenca nr. 32. Pyetësori i studentëve.pdf</i>			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ konstatoi se zyra e NJSBC, harton një raport vjetor me rezultatet e pyetësorit, i cili shqyrtohet nga strukturat vendimmarrëse në nivel institucioni dhe njësie kryesore. Pjesë të këtij raporti përfshihen edhe në raportin vjetor të institucionit. <i>Evidenca nr. 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf</i> <i>Evidenca nr. 17. Raporti vjetor 2021-2022 dhe shkresa përcjellëse në MAS..pdf</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Pavarësisht se raporti publikohet në terma të përgjithshëm të gjetjeve, <i>GVJ sugjeron</i> që në këto raporte të identifikohen shembujt dhe praktikatat e mira, për promovimin e kulturës së cilësisë, sikurse edhe diskutimin në rang departamenti të gjetjeve kryesore në terma të përgjithshëm si dhe ndarjen me stafin në mënyrë konfidenciale të rezultateve të vlerësimit, të secilit pedagog.			
Konkluzione	<i>GVJ lidhur me këtë standard, është i mendimit se Kolegji Universitar Reald, ka një politikë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit të mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe	Referuar strukturave të sigurimit cilësisë, rezulton se KUR, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Cilësisë në nivel IAL (sipas ligjit 802015), që kryejnë procedurat administrative për monitorimin e cilësisë, organizimin e pyetësorit, përpunimin e tij dhe hartimin e raportit si dhe strukturat e njësisë bazë dhe kryesore, të cilat ndjekin monitorimin e vazhdueshëm të mbarëvajtjes së programit të studimit Bachelor në

<p>me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Financë. Këto struktura funksionojnë mbi bazë të statutit dhe rregullores së KUR si dhe rregullores së NJSBC.</p> <p><i>Evidenca nr. 8. Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 25. Të dhëna për strukturën e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 4. Plan pune i NJSBC.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Referuar përbërjes së Njësisë të Sigurimit të Cilësisë, ai rezulton të kryesohet nga drejtuesja e zyrës së Këshillimit të Karrierës, nga një përfaqësues nga çdo njësi kryesore, një përfaqësues i studentëve dhe një ekspert i jashtëm. Kjo strukturë funksionon mbi bazë të rregullores së NJSBC.</p> <p><i>Evidenca nr. 8. Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 25. Të dhëna për strukturën e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 56. Urdhër i Rektorit për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm për hartimin e RVB..pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>KUR rezulton të ketë përfunduar akreditimin institucional si dhe i nënshtrohet akreditimit programor, sic është edhe ky proces vlerësimi.</p> <p>Përveç akreditimit institucional si sigurimi i jashtëm i cilësisë, institucioni realizon procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë nga NJSBC.</p> <p>Referuar raportit të cilësisë, rezulton se analizohen disa indikatorë në terma sasiorë sipas frekuencës në përgjigje të studentëve, për pyetjet që përmban pyetësori dhe mbi to, konstatohet se janë lënë rekomandime nga grupi zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, për të cilat strukturat respektive të KUR, duhet të ndjekë plotësimin e tyre në vazhdimësi.</p> <p><i>Evidenca nr. 8. Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për</p>	<p>Nga dosja e vlerësimit të brendshëm dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se përdoren disa mekanizma, si monitorim i vazhdueshëm nga njësia bazë/kryesore, sondazhi i studentëve me një periodicitet dy herë/vit për vlerësimin akademik, pyetësori për vlerësimin e infrastrukturës si dhe pyetësori i kënaqësisë së stafit si dhe monitorimi i procesve të mësimdhënies.</p> <p><i>Siç u konstatua dhe diskutua edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ sugjeron që rezultatet e pyetësorëve ti shpërndahen edhe individualisht</i></p>

arritjet më të mira ne programin e studimit.	<p><i>stafit akademik, të diskutohen rezultatet dhe të orientohen me rekomandime për përmirësim.</i></p> <p><i>Evidenca nr. 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 4. Plan pune i NJSBC.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se Kolegji Universitar Reald, harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Financë, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. GVJ sugjeron që rezultatet e pyetësorëve ti shpërndahen edhe individualisht stafit akademik, të diskutohen rezultatet dhe të orientohen me rekomandime për përmirësim.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve</p>	<p>Në DVV, GVJ konsultoi planin e punës së NJSBC dhe identifikoi disa mekanizma të përdorur formal - sondazhe çdo fund semestri, për të vlerësuar aspekte të cilësisë së programeve të studimit, relacion mbi sezonet e provimeve, kontroll i evidencave dhe regjistrave, anketimet periodike të studentëve si dhe relacion për zhvillimin e praktikave dhe të diplomave, etj.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe takimet me përfaqësues të zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, rezulton se rezultatet e sondazheve të studentëve dokumentohen dhe analizohen, hartohet në vijim një raport përmbledhës që përmban rekomandime sipas gjetjeve, duke synuar të adresojë problematikat e hasura nga sondazhet nëpërmjet drejtuesit të njësisë bazë, të njësisë kryesore apo strukturave të tjera që kanë në përgjegjësinë e tyre problematikën e identifikuar.</p> <p>Gjithashtu institucioni nëpërmjet një procesi formal, ka ngritur GVB, që ka hartuar RVB dhe ka përgatitur dosjen e vetëvlerësimit për qëllim akreditimi, dokumentacionit të së cilës, i jemi referuar vazhdimisht si GVJ, gjatë këtij procesi.</p>

<p>përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p><i>Evidenca nr. 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 4. Plan pune i NJSBC.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Referuar RVB, rezultoni se raporti i vlerësimit të brendshëm, përmban pikat e forta dhe të dobta të programit të studimit Bachelor në Financë.</p> <p>Gjithashtu referuar raportit vjetor të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ai përmban analizën e gjetjeve kryesore dhe rekomandime të lëna për adresimin e problematikave, për strukturat specifike akademike dhe/ose administrative të KUR.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ konstatoi se për programin e studimit Bachelor në Financë, përdoren metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, të cilat shihen se janë të përfshira në seksionet e pyetësorit që aplikohet deri tani, në sondazhet e studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre</p>	<p>Sic GVJ është shprehur edhe për vlerësimin e kriterëve më sipër, KUR për vlerësimin e cilësisë, përdor sondazhin e studentëve, monitorimin e procesit mësimor dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik.</p> <p><i>GVJ sugjeron krijimin e një Keshilli/Bordi Pune, i cili do të krijonte mundësi për të tërhequr opinionin e bizneseve lokale dhe Alumnit dhe sugjerimet për përshtatjen me kërkesat në zhvillim të tregut të punës për aftësi dhe zotësi që studentët e diplomuar duhet të kenë, në</i></p>

<p>të diplomuar (alumni), të përsonelet akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p><i>përfundim të Bachelor në Financë për të qenë më konkurrues në tregun rajonal dhe më gjerë.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ është e mendimit se KUR monitoron dhe vlerëson përmes NJSBC, njësisë bazë dhe kryesore, në mënyrë periodike programin e studimit, Bachelor në Financë, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. Pavarësisht për sa më sipër, GVJ sugjeron që IAL të përfshijë stakeholders(bashkëpunëtorë) të jashtëm si, bizneset dhe Alumnin në vlerësimin e programit të studimit Bachelor në Financë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, përsonelet akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në përbërje të njësisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rezulton se çdo njësi kryesore ka përfaqësues të saj. Gjithashtu, studentët përfaqësohen nga një anëtar, duke garantuar përfaqësim të gjithë aktorëve të brendshëm, staf akademik dhe studentë. Pjesë e NJSBC, është edhe një ekspert i jashtëm nga i cili institucioni mund të marrë sugjerime për përputhshmërinë e programeve të studimit me kërkesat e biznesit lokal dhe tregut të punës.</p>
	<p><i>Evidenca nr. 25. Të dhëna për strukturën e NJSBC.pdf</i> <i>Evidenca nr. 56. Urdher i Rektorit për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm për hartimin e RVB..pdf</i></p>




<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Të gjitha strukturat e përfshira në sigurimin e cilësisë, si NJSBC, njësia kryesore, njësia bazë etj, i kanë të sanksionuara të drejtat dhe detyrimet e tyre në Rregulloren e institucionit. NJSBC gjithashtu operon mbështetur në rregulloren e organizimit të NJSBC. Në këto akte rregullatore rezultojnë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet e palëve si dhe procedurat që ndiqen.</p> <p><i>Evidenca nr. 8. Rregullore e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 25. Të dhëna për strukturën e NJSBC.pdf</i></p> <p><i>Evidenca nr. 56. Urdhër i Rektorit për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm për hartimin e RVB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet se anëtarë të njësisë kryesore janë pjesë e NJSBC përveç faktit që siç rezultoi nga vizita në institucion, anëtarët e departamentit janë pjesë edhe e grupeve të vlerësimit të brendshëm programor.</p> <p>Gjithashtu studentët kanë përfaqësuesin e vet, në NJSBC si dhe në GVB.</p> <p>Përfshirja e të gjitha palëve krijon mundësinë e sjelljes së këndvështrimeve të ndryshme dhe adresimin e çështjeve që janë me interes të gjerë për cilësinë e programit të studimit Bachelor në Financë, si për stafin akademik, studentët dhe institucionin në tërësi.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi se pyetësorët zhvillohen anonim, që studentët të trajtojnë me sa më shumë objektivitet informacionin konfidencial, përpunimi i tyre dhe analizimi bëhet në terma të përgjithshëm, publikimi i gjetjeve është në respekt të integritetit akademik dhe synon të shmangë diskriminimin apo pabarazinë kundrejt personelit të vlerësuar dhe studentëve që kanë vlerësuar.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>NJSBC ka në përbërje të saj edhe një përfaqësues si ekspert i jashtëm, që parimisht mund të sjellë një këndvështrim të rëndësishëm, nën optikën e tregut të punës, në vlerësimin e programeve të studimit.</p> <p><i>Evidenca nr. 56. Urdhër i Rektorit për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm për hartimin e RVB.pdf</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ është e mendimit se KUR përfshin të gjithë aktorët e brendshëm, staf akademik, njësi kryesore, bazë dhe NJSBC, në sigurimin e cilësisë. Në këto struktura ka përfaqësues të studentëve dhe ekspertë të jashtëm.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht		Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ referuar DVV dhe webit zyrtar të KUR, konstaton se rregullore e NJSBC, përbërja e NJSBC si dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. <u>sigurimi i cilësisë - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al)</u> <u>Raporti Vjetor - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al)</u>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Rregullore e NJSBC, Plani i punës së NJSBC dhe raporti vjetor, rezultojnë të publikuar në faqen zyrtare. Raporti respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. <u>Raporti Vjetor - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al)</u> <u>RREGULLORE E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË (N.J.S.B.C) - Kolegji Universitar Reald (unireald.edu.al)</u>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Ky raport rezulton të ketë të përcaktuara edhe masat për përmirësim të mëtejshëm në nivel institucioni, edhe pse GVJ është e mendimit se raporti duhet të jetë më i detajuar dhe rekomandimet më specifike. GVJ konsultoi dy raporte, raportin vjetor të institucionit, që një nga çështjet që trajton ka Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë si dhe raportin e NJSBC. Raporti i NJSBC, përmban analizë përshkruese të rezultateve të anketimeve, ai shoqërohet me përfundime si dhe rekomandime. <i>Evidenca nr. 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf</i>

<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, raporton në mënyrë të vazhdueshme, për procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, në të cilën adresohen edhe rekomandime mbi gjetjet e sondazhit të studentëve.</p> <p><i>Evidenca nr. 30. Raport vjetor i monitorimit të sigurimit të cilësisë NJSBC.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi me strukturat drejtuese rezultojnë se KUR, nëpërmjet strukturave drejtuese, njësisë kryesore apo/edhe njësisë bazë, organizon veprimtari me stafin akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, nëpërmjet promovimit të pjesëmarrjes në trajnime, për akreditimin institucional dhe atij programor. <i>Pavarësisht për sa më sipër, nga vizita në institucion, GVJ sugjeron që stafi dhe studentët duhet të jenë më të sensibilizuar, informuar e ndërgjegjësuar, rreth proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe rolit të tyre dhe strukturave të tjera në këtë proces.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ është e mendimit se proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit në Bachelor në Financë, janë publike dhe transparente dhe synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe rritjen e qëndrueshmërisë së programit të studimit Bachelor në Financë.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që stafi dhe studentët duhet të jenë më të sensibilizuar, informuar e ndërgjegjësuar, rreth proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe rolit të tyre dhe strukturave të tjera në këtë proces.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Finance" të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar "REALD"

Pika të forta:

1. Mbështetja institucionale e studentëve dhe fryma pozitive e krijuar nga departamenti jep ndikim pozitiv në mbarëvajtjen e procesit mësimor, informimit dhe shprehjen e mendimit të lirë nga studentët.
2. Infrastrukturë fizike dhe të teknologjisë së informacionit bashkëkohore.
3. Struktura e kerkimit shkencor me vizion dhe e orientuar drejt cilesise
4. Lidhje efektive me botën e biznesit premtojnë krijimin e nje network funksional për praktikat e studentëve, punësimin dhe marrjen e feedbackut për përmirësimin e programit.

Pika të dobta:

1. Plani Mësimor i programit (Evidenca 13; 14) i pa standardizuar me veprimtaritë formuese (A-E) në konform VKM 41/2018 i përditësuar (shtojca 1). *(Standardi II.1 /Kriteri 1)*
2. Shtim të bashkëpunimeve dhe pjesëmarrjeve në projekte kërkimore brenda dhe jashtë vendit si dhe rritja dhe zgjerimi i partneriteteve ndërkombëtare për mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik në kuadër të ERASMUS +. *(Standardi I.2/Kriteri 2)*
3. Biblioteka me numër të kufizuar titujsh, me nevoja për azhornim dhe mungesë e rregjistrimeve në librari elektronike *(Standardi IV.3 /Kriteri 4)*
4. Numri i vogël i studentëve në programin e studimit *(Standardi V.4 /Kriteri 5)*
5. Stafit akademik dhe studentë kanë nevojë për më shumë informim dhe sensibilizim rreth proceseve të sigurimit të brendshëm të Cilësisë *(Standardi VI.5 /Kriteri 5)*

Rekomandime:

1. GVJ sugjeron përmirësimin dhe standardizimin e syllabuseve te programit Bachelor në Finance (përditësimi i literaturës detyruese). NJSBC duhet të përfshihet më shumë në monitorime që garantojnë cilësinë e formatimit dhe përditësimit të syllabuseve.
2. GVJ sugjeron pasurimin e dhe përditësimin e fondit të bibliotekës fizike me botimet recente të titujve në përputhje me programin e studimit bachelor në Financë.dhe regjistrim në biblioteka elektronike të aksesueshme nga stafi dhe studentët.
3. GVJ sugjeron se zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, duhet të planifikojë dhe të organizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe më të shpeshtë, aktivitete informuese dhe orientuese për studentët, në lidhje me internshipe pranë kompanive dhe për punësimin e tyre të ardhshëm. Këto aktivitete sugjerohen të jenë më të, organizuara, të formalizuara dhe me të gjurmueshme.
4. GVJ sugjeron, që institucioni duhet të intensifikojë përpjekjet për rritjen e numrit të studentëve të regjistruar në programin e studimit bachelor në Finance si dhe të cilësisë së tyre.

5. GVJ sugjeron që IAL të përfshijë stakeholders të jashtëm si, bizneset dhe Alumnin në vlerësimin e programit të studimit Bachelor në Finance. GVJ sugjeron që stafi dhe studentët duhet të jenë më të sensibilizuar, informuar e ndërgjegjësuar, rreth proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe rolit të tyre dhe strukturave të tjera në këtë proces.

Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor in "Finance" offered by the Institution of Higher Education University College "REALD"

Strengths:

1. The institutional support of students and the positive spirit created by the department gives a positive impact on the progress of the learning process, information and the expression of free opinion by students.
2. Physical infrastructure and contemporary information technology.
3. The structure of scientific research with a vision and oriented towards quality
4. Effective connections with the business world promise the creation of a functional network for student internships, employment and receiving feedback for program improvement.

Weak points:

1. The Learning Plan of the program (Evidence 13; 14) not standardized with formative activities (A-E) in accordance with VKM 41/2018 updated (appendix 1). (*Standard II.1 / Criterion 1*)
2. Increasing cooperation and participation in research projects inside and outside the country as well as the growth and expansion of international partnerships for the mobility of students and academic staff within the framework of ERASMUS +. (*Standard I.2 / Criterion 2*)
3. Library with a limited number of titles, in need of updating and lack of registrations in electronic bookstores (*Standard IV.3 / Criterion 4*)
4. Small number of students in the study program (*Standard V.4 / Criterion 5*)
5. Academic staff and students need more information and awareness about internal Quality assurance processes (*Standard VI.5 / Criterion 5*)

Recommendations:

1. EEG suggests improving and standardizing the syllabuses of the Bachelor in Finance program (updating the mandatory literature). Internal quality assurance unit, should be more involved in monitoring that guarantees the quality of syllabus formatting and updating.
2. EEG suggests enriching and updating the physical library fund with recent editions of titles in accordance with the bachelor's study program in Finance and registration in electronic libraries accessible by staff and students.
3. EEG suggests that the Career and Alumni Counseling office should plan and organize, on a continuous and more frequent basis, informative and orientation activities for students, regarding internships at companies and for their future employment. These activities are suggested to be more organized, formalized and traceable.



4. EEG suggests that the institution should intensify efforts to increase the number of students enrolled in the bachelor study program in Finance as well as their quality.

5. EEG suggests that HEI include external stakeholders such as businesses and Alumni in the evaluation of the Bachelor in Finance study program. EEG suggests that staff and students should be more sensitized, informed and aware about internal quality assurance processes and their role and other structures in this process.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X